



JOHN BLANCHARD

A MUND TË JEMI TË

**MIRË**

PA

**PERËNDINË**

**?**

**A MUND TË JEMI TË  
MIRË  
PA  
PERËNDINË  
?**

John Blanchard

Titulli i originalit: Can we be good without God?  
Botuesi i originalit: Evangelical Press, Darlington, DL3 0PH, England.  
ISBN Original: 978-085-234-6518

Titulli në Shqip: A mund të jemi të mirë pa Perëndinë?  
Botuesi: AEM-Misioni Ungjillor, Gjirokastrë, Albania,  
(në bashkëpunim me Illyrian Gospel Trust).  
< wdniven@hotmail.co.uk>

Autori: John Blanchard  
Përktheu: Blerina Pano  
Redaktoi: Valbona Nikolla

E drejta e botuesit: © AEM-Misioni Ungjillor, Gjirokastrë, Albania, 2010.  
Boton: AEM-Misioni Ungjillor.

Të drejtat e rezervuara: Asnjë pjesë e këtij botimi nuk duhet të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre, elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi, apo ndonjë mënyrë tjetër pa marrë leje me shkrim nga botuesi; “AEM-Misioni Ungjillor”  
<office@aemission.org>

Citimet Biblike janë marrë nga Bibla, “Diodati i Ri,” (1991-1994). E drejta e autorit © SHOQERIA BIBLIKE SHQIPTARE (A.B.S) TIRANË. E përdorur me leje.

Shtypur: Vernon Publishing,  
Tirana, Albania, 2010  
Tirazhi: 3,000 kopje

ISBN: 978-99943-55-82-2



# A mund të jemi të mirë pa Perëndinë?

Në dhjetor të vitit 2005, një film i prodhuar në Hollivud dhe i shfaqur kryesisht në Zelandën e Re përfshiu Britaninë me një valë të madhe publiciteti. Me një çmim prej 150 milionë dollarësh, kishte tërhequr tashmë shumë spektatorë në Shtetet e Bashkuara. Tani, ndërsa mbërriti në vendlindjen e autorit, mbi librin e të cilit është mbështetur skenari, përgjigjja ishte fenomenale, jo vetëm prej kritikëve profesionistë të filmave. Në *"Daily Mail"*, Chris Tookey e hap analizën e tij duke thënë: "Ja një film i mrekullueshëm, kolosal, i mahnitshëm . . . Ky nuk është vetëm një film që "duhet parë", por që "duhet parë e riparë". Ai vazhdon duke e quajtur cilësinë e aktrimit "të pakrahasueshme", efektet speciale "mbresëlënëse" dhe kulmin "vërtet të mahnitshëm"<sup>1</sup>. Gazeta të tjera shtuan mbështetjen e tyre entuziaste. *"Daily Express"* e quajti "magjik"; *"Sunday Express"* tha se ishte "magjepsës" dhe *"Metro"* mendonte se ishte "i bujshëm".

Pothuajse po aq i jashtëzakonshëm sa ishte kori i lavdërimeve ishte edhe fakti që filmi nuk kishte asnjë prej elementeve që gjenden shpesh në filmat modernë. Edhe pse përmbante disa skena të gjalla beteje, nuk kishte asnjë ndyrësi, asnjë përdhosje, seks të ndyrë, asnjë prerje dhe asnjë lakuriqësi. Përkundrazi, ai shprehte mbështetje për besim dhe moral. Ashtu si shprehet Christopher Hart i *"Daily Mail"*, ishte "një histori rreth besnikërisë në çast të vështirë ose jo, dobësisë njerëzore, kujdesit për njëri-tjetrin, guximit, faljes, sakrificës dhe shpëngimit".

Filmi ishte *"Luani, Shtriga dhe Dollapi i rrobave"* ("The Lion, the Witch and the Wardrobe"), i pari nga gjashtë filma që mendohen të bëhen të mbështetur në *"Kronikat e Narnias"* ("Chronicle of Narnia"), një seri librash të shkruar nga autori britanik, i respektuar botërisht, C. S. Lewis, rreth pesëdhjetë vjet më parë. Edhe pse jo të mirëvlerësuar në fillim, ata u bënë gradualisht të njohur dhe mbi 100 milionë kopje u shitën në kohën kur përshtatja e parë filmike mbërriti në kinema. Në fundjavën hapëse arkëtimet nga biletaria arritën në 67.1 milionë dollarë dhe fitoi lavdërimi nga njëri breg në tjetrin. *"New York*

*Daily News*” e vlerësoi atë “një sukses emocionues”<sup>2</sup>, *“San Francisco Chronicle”* tha se ishte “një film për inteligjencën dhe fuqinë, bukurinë, universalitetin dhe madhësitë e shpirtit”,<sup>3</sup> ndërsa *“Baltimore Sun”* e quajti atë “plotësisht fisnikërues”.<sup>4</sup>

Megjithatë, jo të gjithë ishin dakord. Pas shfaqjes për herë të parë në Britani, Polly Toynbee e *“Guardian”* e sulmoi. Një pjesë e tij asaj i dukej si “i neveritshëm, i turpshëm dhe i tmerrshëm”; të gjithë filmin e shihte si të ishte “thellësisht manipulues” dhe “të errët me sadizëm emocional” dhe citoi me miratim dënimin që autori Philip Pullman i bënte *“Kronikave të Narnias”* si “një prej gjërave më të shëmtuara dhe helmuese që kishte lexuar ndonjëherë”.<sup>5</sup> Çelësi për të kuptuar shpërthimin shkatërrues të Toynbee bëhet i qartë në fund të analizës së saj, kur ajo sulmon personazhin kryesor si “një emblemë të gjithçkaje që një ateist kundërshton në fe”. Kjo zbulon një të fshehtë të madhe, sepse na tregon se ajo po shkruante jo si një kritike objektive filmi, por si një ateiste e vendosur, e bindur se, ndërsa përballemi me konfliktin e vazhdueshëm mes së mirës dhe së keqes, nuk ka asnjë Perëndi tek i cili të drejtohem. Sipas fjalëve që thotë ajo vetë: “Askush nuk shikon, askush nuk drejton, askush nuk gjykon dhe nuk ka asnjë vend tjetër më pas . . . Nuk ka asnjë tjetër, veç nesh, për të vuajtur për mëkatet tona, askush që të na shpengojë, veç vetja jonë . . . Nuk kemi nevojë për libra të shenjtë udhërrëfimi, veç për një busull shumë njerëzore”. Kjo gjë përgatit përsosmërisht skenën për gjithçka që do të vijojë në këtë broshurë.

## Pikënisja

Pika kryesore e Polly Toynbee është se, në mungesë të Perëndisë, ne jemi përsosmërisht në gjendje jo vetëm të shpengohemi nga efektet e dëmshme të së keqes, por që edhe të nxjerrim, pikë së pari, një dallim të qartë mes së keqes dhe së mirës. Gjithçka që kemi nevojë për të bërë këtë dallim të rëndësishëm është “një busull shumë njerëzore”. Por a qëndron këtu kjo çështje? Nëse Perëndia nuk ekziston, a mund të diskutojmë nëse diçka është “e mirë” apo “e keqe”? Kjo është pikënisja e vërtetë.

Kushdo e ka një botëkuptim, përderisa ai thjesht do të thotë mënyra se i ti i shikon gjërat, duke përfshirë historinë, botën natyrore, jetën tënde dhe atë të të tjerëve. Ai sundon besimet e tua bazë rreth realitetit, duke përfshirë këndvështrimin tënd të plotë mbi universin dhe vendin tënd në të. Po të shprehemi shkurt, një botëkuptim është mënyra se si e sheh ti botën. Për të përdorur një ilustrim të thjeshtë, po themi se botëkuptime të ndryshme janë

si njerëz që shohin të njëjtën skenë përmes syzesh dielli të lyera me ngjyra të ndryshme. Botëkuptimi juaj ndikon të gjitha ato që ti mendon, thua ose bën, sepse më parë vjen ajo që ti supozon se është e vërtetë, para se të pohosh se çdo gjë tjetër është e vërtetë, prandaj është e lehtë të kuptosh se kjo, në mënyrë radikale, ndikon pikëpamjen tënde të etikës dhe moralit.

Sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe, fjala “etikë” përkufizohet si “sistemi i parimeve morale, i normave dhe i rregullave të sjelljes së njerëzve në shoqëri”<sup>7</sup>, ndërkohë që i njëjti fjalor përkufizon “moral” si “tërësia e parimeve dhe e normave të sjelljes në punë e shoqëri”<sup>8</sup>. Duket qartë se të dyja fjalët janë të lidhura ngushtë, edhe pse kuptimi i tyre nuk është shumë i ngjashëm. Po të flasim me terma shumë të thjeshtë, “moral” përkufizon atë që një person beson se është e drejtë ose e gabuar, ndërsa “etika” është studimi i asaj që një person beson se është e drejtë ose e gabuar, prandaj që të dyja, etika dhe morali, varen në mënyrë thelbësore nga botëkuptimi i një individi. Për shembull, Polly Toynbee pa saktësisht të njëjtat pamje dhe dëgjoi saktësisht të njëjtën kolonë zanore që panë e dëgjuan kritikët që e lavdëruan deri në qiell “Luani, Shtriga dhe Dollapi i Rrobave”, megjithatë, ashtu siç e bëjnë të qartë edhe fjalët e fundit të analizës së saj, sulmi i saj përçmues nuk u shkaktua nga një ndryshim në intelekt, kombësi apo paragjykim kulturor, por nga botëkuptimi i saj.

Botëkuptimet mund t’i ndajmë në tri kategori, sipas qëllimeve tona të tanishme. Së pari, janë ato që supozojnë një botë pa Perëndi, siç është humanizmi (njeriu është në qendër të gjithçkaje), materializmi (vetëm natyra ekziston), ekzistencializmi (nuk ka vlera universale) dhe nihilizmi (asgjë nuk ka ndonjë domethënie përfundimtare). Së dyti, janë ato që lidhen në një prej sistemeve fetare të panumërta që ka shpikur njeriu gjatë shekujve. Këto variojnë nga Hinduizmi (i cili ofron mbi tridhjetë milionë perëndi) deri te Zoroastrianizmi (që thotë se ka dy), dhe përfshin një kaskadë çoroditëse konceptesh, sipas të cilave Perëndia shihet si një forcë natyrore, energji kozmike, një frymë që jeton në gjithë elementet materiale ose (si në rastin e Islamit) si një Sundues i largët dhe i rreptë, “që qëndron kaq sipër njeriut nga çdo anë, saqë nuk mund të njihet personalisht”<sup>9</sup>. Së treti, është ajo kategori botëkuptimesh që e sheh Perëndinë, i cili e shfaq veten në Bibël, jo vetëm si Krijues i gjithë realitetit jashtë vetes së tij dhe si Sunduesi i vetëm e sovran i gjithë krijimit të tij, por si ai që i krijoi qeniet njerëzore si agentë moralë, i cili shqetësohet për mirëqenien tonë morale dhe që na thërret në një marrëdhënie të gjallë me të.

Ky është Perëndia për të cilin mendoj kur shkruaj këtë broshurë, prandaj pyetja që duhet të bëjmë dhe së cilës duhet t’i përgjigjemi është kjo: a mund të

ketë kuptim të flasim rreth së mirës dhe së keqes nëse të menduarit tonë nuk sundohet nga ky botëkuptim?

## Muri i Kantit

Shumë mendimtarë të shquar të botës janë munduar me pyetjen tonë. Një ndër më kryesorët ishte filozofi gjerman i shekullit XVIII-të Emanuel Kant (Immanuel Kant). “Ideja e madhe” e tij ishte se gjithë njohuria mund të ndahej në dy “botë”. Njëra përfshinte gjërat që shqisat tona dallonin, të parit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit dhe të prekurit, ndërsa në tjetrën Kanti vendoste Perëndinë dhe çdo gjë që nuk mund të dallohej nga shqisat tona apo që nuk mund të demonstrohej shkencërisht. Ai në të vërtetë vendosi një “mur” midis këtyre dy botëve dhe tha se, si qenie njerëzore, ne nuk kishim aftësinë ta kalonim këtë mur dhe ta zotëronim “botën” e dytë. Është ironike që, ndërsa emri i tij “Emanuel” është fjalë hebraike dhe ka kuptimin “Perëndia me ne”, mësimi i Kantit i ka drejtuar miliona njerëz të besojnë se, në vend që të jetë “me ne”, Perëndia është mbyllur në një botë që ne nuk mund ta arrijmë!

Ndërsa Kanti e vendosi moralin në faqen më të largët të “murit” të tij, ai thoshte se gjykimet rreth së drejtës dhe së gabuarës ishin çështje të mendimit personal, prandaj është e lehtë të kuptosh që “busulla njerëzore” e Polly Toynbee lidhet me këtë ide. Gjurmët e gishtave të Kantit gjenden kudo në idenë e dalë mode se, ndërsa shkenca merret vetëm me fakte, feja është thjesht çështje besimi dhe spekulimi. Megjithatë, edhe ai e pranoi se kishte një fushë të përvojës njerëzore që kërkonte ekzistencën e Perëndisë, dhe një mbishkrim në gurin e varrit të tij na tregon se cila ishte ajo: “Dy gjëra e mbushin mendjen time me habi dhe çudi përherë të re e që rritet vazhdimisht sa më shpesh dhe sa më shumë që reflektimi zë vend në to: qiejt me yje sipër dhe *ligji moral brenda*” (theksimi i bërë nga autori).

Në rrjedhën e shkrimeve të tij Kanti debatonte se, ndërsa ky ligj morali universal nuk ishte diçka që njeriu e kishte shpikur, duhet të vinte nga diçka që ai e quante “Qenie Supreme”, i cili na dha liri të bindeshim ose jo dhe që do të ushtronte drejtësi të përsosur përtej varrit. Edhe pse ideja që ai kishte për Perëndinë (një hyjni jopersonal që krijoi universin dhe që pastaj e braktisi atë) është larg mësimi të Biblës, ai prapëseprapë arriti në përfundimin se “duhet të jetojmë sikur të kishte një Perëndi”. Edhe ky skeptik madhështor zbuloi se nuk mund të ndërtonte një model moralshmërie pa futur, si të thuash, kontrabandë Perëndinë në të, sepse pa Perëndinë koncepti i etikës nuk do të kishte kuptim dhe e lë jetën njerëzore pa ndonjë spirancë morale.

## Një dimension tepër

Asgjë prej atyre që janë thënë më sipër nuk sugjeron se njerëzit që dyshojnë ose mohojnë ekzistencën e Perëndisë nuk janë në gjendje të bëjnë gjëra që zakonisht pranohen si “të mira”. Kjo do të ishte një ide qesharake. Ashtu siç e kemi pohuar tashmë, pyetja që po konsiderojmë shkon shumë më thellë se kaq dhe kërkon, së pari, se çfarë baze kemi për të përshkruar ndonjë mendim, fjalë apo veprim si “të mirë” ose “të keq”. Për shembull, në një botë pa Perëndinë a mund të kemi ndonjë arsye të fortë që t’i quajmë disa gjëra të tilla si pastërtia, ndershmëria dhe përlësia “të mira”, apo të kundërtat e tyre “të këqija”?

Matematikani dhe humanisti britanik, i lindur në Poloni, Jacob Bronowski, dikur shkroi: “Njeriu nuk është i ndryshëm në lloj nga ndonjë formë tjetër e jetës . . . materia e gjallë nuk është e ndryshme në lloj nga materia e vdekur . . . Është e qartë të thuash që njeriu është pjesë e natyrës, në po të njëjtin kuptim që është edhe një gur, një kaktus apo një gamile”<sup>9</sup>. Kjo është tipike për pikëpamjet e shprehura nga ateistë të vendosur, por gjithë evidenca është kundër kësaj. Ka shumë mënyra në të cilën jeta njerëzore është thelbësisht e ndryshme, jo vetëm nga bota natyrore, por edhe nga çdo formë tjetër e jetës në tokë. Ne kemi inteligjencë shumë të lartë, jemi qenie historike, të vetëdijshme për të shkuarën tonë dhe të shqetësuar për të ardhmen; kemi një instinkt të rrënjosur thellë se jemi më shumë se aksidente atomike; e përdorim gjuhën në mënyrë unike; jemi të aftë për arsyetim kompleks dhe të menduar imagjinar; kemi aftësi matematikore; dhe kemi një dimension estetik që na bën të aftë t’i cilësojmë gjërat si të bukura ose të shëmtuara.

Por njerëzimi ka një shenjë tjetër dalluese që është kaq universale dhe e fortifikuar, saqë askush në mënyrë të ndershme apo logjike nuk mund ta mohojë atë: *ne kemi një dimension moral*. Për mijëra vite është pranuar universalisht se ka një ndryshim radikal mes së drejtës dhe së gabuarës, prandaj duket e vështirë të mohosh se një ligj moral shfaqet i programuar në “softuerin” tonë psikologjik.

Sistemet e drejtësisë kundër krimit do të binin në kaos po të mos ndodhte kështu. Nëse një avokat do t’i kërkonte një gjyqi të rrëzonte akuzën kundër një klienti, apo t’i jepnin dënimin më të lehtë të mundshëm, në bazë të asaj që personi në bankën e të akuzuarit nuk ishte në dijeni të ndryshimit midis së drejtës dhe së gabuarës, ai, në të vërtetë, do të ishte duke pohuar se personi që po mbronte për ndonjë arsye nuk ishte i aftë të vepronte si një qenie njerëzore normale, sepse asnjë person me gjykim të shëndoshë nuk e mohon se ka një ndryshim të tillë. Ashtu si C. S. Lewis vë në dukje në “*Mere Christianity*” (“Krishterim

i thjeshtë”): “Qeniet njerëzore, kudo në tokë, kanë këtë ide të çuditshme se duhet të sillen në një mënyrë të caktuar dhe nuk mund të shpëtojnë prej saj”.<sup>10</sup> Edhe pse interpretimi i një ligji të shkruar mund të ndryshojë nga shoqëria në shoqëri dhe nga individ në individ, është e pamundur të mohohet që mbi çështje të shumta morali që ndikojnë gjithë njerëzimin ka një konsensus të jashtëzakonshëm, në të cilin nuk është arritur duke kombinuar ide dhe duke farkuar ndonjë lloj kompromisi.

## Ndërhryësi

Në qershor të vitit 2006, shtypi britanik nxori një histori të mrekullueshme që ilustronte pohimin e C. S. Lewis-it. Duke rrëmuar në xhepat e një xhakete të vjetër, tetëdhjetekatërvjeçari John Gedge, nga Saseksi Lindor, gjeti një gjobë të papaguar që i ishte vënë për kalim të shpejtësisë, e cila tregonte se ai ishte kapur duke ngarë me 88 km/orë në një zonë ku shpejtësia e lejuar ishte 56 km/orë, ndërsa ishte me pushime në Amerikë, më 1954-ën, mbi pesëdhjetë vjet më parë. Sapo e gjeti gjobën, ai e dërgoi shumën që duhej, shoqëruar me një letër ku kërkonte ndjesë. Kjo tregon integritet të madh, por përse duhej ta ndiente nevojën për të vepruar kështu? Askush tjetër nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur dhe nuk ishte më në rrezik se do ta kërkonin, e megjithatë, e ndjeu se ishte gabim ta linte pas dore. Përse? Përse dhe si bëhemi të vetëdijshëm për çështjet morale? Përgjigjja e drejtpërdrejtë është se vetëdija jonë e moralshme ndizet nga ndërgjegjja, një monitor moral i mistershëm që i fut hundët në çdo vrimë të jetës sonë, nga dhoma e gjumit në shtëpi te salla e mbledhjeve në punë dhe nga mënyra se si i shpenzojmë paratë te mënyra si e përdorim kohën.

Ndërgjegjja është më shumë se instinkt apo dëshirë. Ka kohë kur kemi instinkt apo dëshirë për të bërë diçka, por ndërgjegjja na thotë se nuk duhet ta bëjmë; dhe ka kohë kur kemi instinkt ose dëshirë për të mos bërë diçka, por ndërgjegjja na thotë se duhet ta bëjmë. Jo çdo instinkt apo dëshirë ka gjithmonë të drejtë në vetvete, por morali po, dhe ndërgjegjja jo vetëm na çon në një ligj moral, por na tregon në terma jo të pasigurt se duhet t'i bindemi asaj. Duke vendosur një lidhje mes të dyjave, Phillip Johnson thotë për ligjin moral: “Është pikërisht të kuptuarit moral themelor që nuk mund të mos e njohim, sado shumë të përpiqemi ta shmangim atë njohuri, sepse ndërgjegjet tona dëshmojnë për të”.<sup>11</sup>

Edhe pse nuk ka pushtet të detyrojë bindjen tonë, ndërgjegjja arrin ta gjejë rrugën e vet tek të menduarit tonë sa herë që përballemi me zgjedhje morale. Madje edhe njerëzit që mohojnë ekzistencën e vlerave morale objektive bien

dakort se ka detyrim moral personal, se është e drejtë t'i bindesh ndërgjegjes dhe se është e gabuar të mos i bindesh. Por cili është burimi i autoritetit të saj? Si lidhet ajo me ligjin moral? Sado të shumta të jenë këto pyetje, përgjigjja duhet të vijë nga njëra prej vetëm katër mundësive.

## Nga atomet tek etika?

Mundësia e parë është se sensi ynë i moralshmërisë vjen nga natyra, që, në një mënyrë apo në një tjetër, e gjen rrugën e vet për të gjetur tona përgjatë një procesi të gjatë evolucionit. Kjo është linja që kanë përshtatur dy materialistë të njohur, biologu Edward Wilson dhe filozofi i shkencave Michael Ruse: "Moralshmëria, ose, po të shprehemi në mënyrë më strikte, besimi ynë në moralshmëri, është thjesht një adoptim i vendosur për të çuar më tej qëllimet riprodhuese . . . Etika, ashtu siç e kuptojmë atë, është një iluzion me të cilin gjenet tona kanë dashur të na e hedhin". Ajo që ata thonë është se një proces mekanik i rastësishëm na ka futur në kurth që të besojmë në një kod moral që nuk ekziston, sepse bindja ndaj tij është mjeti i vetëm i mbijetesës sonë! Megjithatë, kjo bie plotësisht në kundërshtim si me logjikën ashtu edhe me gjykimin e shëndoshë. Një materialist tjetër, profesor William Provine i Universitetit të Kornellit, shfaq dobësinë e çështjes së tyre ndërsa mbështet botëkuptimin e tyre ateist: "Evolucioni nuk na mëson në të vërtetë asgjë rreth moralshmërisë . . . Ne njerëzit jemi vetëm. Jemi vendosur këtu nga një proces që nuk do t'ia dijë për ne, prandaj na duhet ta zgjidhim vetë si duhet të sillemi me njëri-tjetrin".<sup>12</sup>

Ideja se morali dhe etika janë produkte të natyrës ngre disa pyetje jashtëzakonisht të çuditshme. Nëse universi nuk është asgjë më tepër se materie, energji, kohë dhe rastësi, si mundet që këto të prodhojnë koncepte të së drejtës dhe të së gabuarës? Nëse zoologu amerikan George Gaylord Simpson ka të drejtë kur thotë se "njeriu është rezultat i një procesi natyror dhe të paqëllimshëm që nuk mendonte për të ndërsa ndodhte",<sup>13</sup> si mundet një proces i tillë të prodhojë moralshmëri personale? A mundet që protonet dhe neutronet të na shtypjnë në drejtimin e duhur? Si mundet bota natyrore ose ligjet e natyrës të na bëjnë përgjegjës për sjelljen tonë? A kemi ndonjë detyrim moral ndaj ligjeve të natyrës? Sjellja morale shpesh përfshin dhënien dhe mbajtjen e premtimeve, por, ndonjë që njihet se ka bërë premtime morale ndaj ndonjë gjëje në natyrë apo ligjeve të natyrës, vështirë se do të vlerësohej me notë të lartë për gjykim të shëndoshë!

Duke reflektuar mbi sëmundjen e tij pak para se të vdiste nga kanceri më 1996-n, gazetari i "*Daily Telegraph*", Martin Harris, shkroi: "Në një univers pa

Perëndinë . . . i vetmi urdhërim që të sillesh mirë është njohuria: të sillesh mirë të nderon më shumë sesa të sillesh keq. Është më mirë të jetosh sesa të mos jetosh, prandaj, kur vendosim të jetojmë, i kthejmë vetet tona në krijesa etike”.<sup>14</sup> Artikujt e tij të guximshëm atë vit u lavdëruan gjerësisht, por është e vështirë të kuptosh se si “të vendosësh të jetosh” na bën ne “etikë”. Të tjerë kanë një përgjigje shumë të ndryshme ndaj idesë se nuk jemi më shumë se rezultate të rastësishme të zhvillimit evolucionar. Vrasësi serial amerikan Geoffrey Dahmer vrau shtatëmbëdhjetë njerëz ndërmjet viteve 1978 dhe 1991 (dhe hëngri pjesë trupi nga disa prej tyre). I pyetur në burg përse i kishte bërë ato vrasje, ai u përgjigj: “Sepse besoja se vija nga llumi përmes evolucionit dhe se isha i lirë të bëja çdo gjë që zgjidhja të bëja, për aq kohë sa do të shpëtoja pa u lagur”.

Asnjë person i saktë nuk do të sugjeronte se gjithë evolucionistët janë vrasës apo kanibalë, por dëshmia e Dahmer-it tregon se evolucioni shtron rrugën për shthurjen më të keqe. Nëse nuk jemi më shumë se çanta pjesësh biologjike, atëherë nuk kemi detyrime morale ndaj asgjëje, madje as ndaj çantave të tjera të tilla! Shkencëtari britanik bashkëkohor Rodney Holder i shkon në thelb çështjes kur thotë: “Nëse nuk jemi asgjë veç atome dhe molekula të organizuara në mënyrë të veçantë përmes proceseve të rastësishme të evolucionit, atëherë dashuria, bukuria, e mira dhe e keqja, vullneti i lirë, arsyeja vetë, me të vërtetë, gjithçka që na bën njerëz dhe na ngre mbi pjesën tjetër të rendit të krijuar, e humbasin objektivitetin e tyre. Përse duhet ta dua fqinjin tim, apo të lë gjërat e mia për ta ndihmuar atë? Përkundrazi, përse të mos marrë gjithçka që mundem për veten time, duke shkelur këdo që më zë rrugën?”<sup>15</sup> Nuk është e habitshme që edhe një kryeateist si profesori i Oksfordit Richard Dawkins, ndërsa pohon se ka “një sens fort të zhvilluar të së mirës”, u detyrua të pranonte se “si biolog nuk kishte një tregim të shtjelluar mirë se nga vjen ky sens”,<sup>16</sup> dhe t’i dorëzohej idesë se “dashuria universale dhe mirëqenia e specieve janë koncepte që thjesht nuk kanë kuptim evolucionar”.<sup>17</sup>

Këtu mund të shtojmë edhe diçka tjetër. Nëse nuk jemi më shumë se robotë për t’ia kaluar pjesëzat e ADN-së brezit tjetër, një projekt në të cilin mbijetesa e më të fortit është shenja vendimtare e progresit, përse duhet të marrim mundimin për ata që nuk ka të ngjarë të kontribuojnë në këtë gjë? Përse duhet të kujdesemi për pleqtë, të sëmurët kronikë apo për ata me të meta të trashëgueshme, apo ata që nuk kanë aftësi të nxëni? Me siguri që mënyra më e thjeshtë (dhe më pak e shtrenjtë) për të ndihmuar aktivitetin evolucionar për të vazhduar do të ishte t’i braktisje, dhe sa më shpejt aq më mirë? Edhe ata që janë të përgatitur të mendojnë në këtë drejtim të përgjithshëm detyrohen

të pranojnë se kjo politikë ende e lë pa përgjigje pyetjen rreth originës së moralshmërisë.

Në përpjekje për të gjetur një bazë për sjelljen, natyra nuk është përgjigjja, ashtu siç është e pamundur të hidhesh nga atomet tek etika dhe nga molekulat te moralshmëria. C. S. Lewis e shpreh kështu këtë: “Nëse na duhet të bëjmë gjykime morale (dhe çfarëdo që të themi do të vazhdojmë ta bëjmë këtë në të vërtetë), atëherë duhet të besojmë se ndërgjegjja nuk është produkt i natyrës. Mund të ketë vlerë vetëm nëse është rezultat i ndonjë urtësie morale absolute, një urtësi morale që ekziston absolutisht “vetëm” dhe nuk është produkt i natyrës jomorale, joracionale”.<sup>18</sup>

## Të ndjekësh Frankun?

Këngëtari dhe aktori Frank Sinatra, i cili vdiq më 1998-n, ishte një ikonë amerikane me një reputacion të njohur kudo për zërin e stilin e tij, dhe që Radio 2 e BBC-së e quajti atë “zëri më i madh i shek. XX-të”. Gjithë nekrologjitë e shkruara për të tërhiqnin vëmendje te kënga e tij më e njohur, e cila fillonte me këto fjalë:

*Dhe tani, fundi është afër,  
Kështu përballem me perden e fundit.  
Miku im, do ta them qartë,  
Do ta deklaroj çështjen time, për të cilën jam i sigurt.  
E kam jetuar jetën plotësisht,  
Kam udhëtuar në çdo rrugë  
Dhe për më tepër, më tepër se kaq,  
Veprua sipas mënyrës sime.*

Katër fjalët e fundit jo vetëm reflektojnë stilin e përgjithshëm të jetës së Sinatrës, por ato gjithashtu përputhen me mendimin e kohës së sotme. Në “Desert Island Discs” (“Disqet e Ishullit të Shkretë”), programi mbi fantazinë me kohëzgjatjen më të madhe të radios BBC, në të cilin të ftuarve u kërkohet të zgjedhin tetë këngë që do të donin t’i kishin me vete po të braktiseshin në një ishull të shkretë, “My way” (“Mënyra ime”), në fund u ndalua, sepse kishte kaq shumë njerëz që kërkonin ta dëgjonin atë. Duke shkruar në “Sunday Times”, pak para se Sinatra të vdiste, gazetari Brian Appleyard tha: “Sot nuk kemi rregulla universale . . . Morali modern, nëse ekziston, priret të jetë tërësisht subjektiv”.<sup>19</sup>

Ky është postmodernizëm i pastër që e sheh realitetin si një seri fragmentesh të palidhura me njëra-tjetrën, në të cilat as historia dhe as letërsia nuk mund të na tregojnë ndonjë gjë. “Kuptimi” është diçka e krijuar nga personi që lexon librin, shikon filmin, flet gjuhën apo jeton jetën. Ashtu siç e pohon edhe një shkrimtar modern: “Kuptimi dhe qëllimi janë shkëputur nga e vërteta objektive dhe vetëm kur shkëputen i dorëzohen individit. Por kjo nuk i lë asgjë individit që ta ndajë me ndonjë krijesë tjetër. Nuk ka kuptim në gjuhën e tij, nuk ka kuptim në librat e tij, nuk ka kuptim në historinë e tij dhe nuk ka kuptim në jetën e tij”.<sup>20</sup>

Postmodernizmi është jashtëzakonisht i njohur (madje edhe mes atyre që nuk e kanë dëgjuar asnjëherë fjalën!) për një arsye themelore: ai e fshin Perëndinë nga tabloja. Askush tjetër nuk e ka bërë këtë më të qartë sesa një prej mbrojtësve e tij më të fuqishëm, filozofi francez Jacques Derrida, i cili tha se, kur postmodernizmi përdorej në letërsi, ishte “vdekja e Perëndisë në shkrim”.<sup>21</sup> Postmodernizmi pjell dy ide të lidhura ngushtë, relativizmin dhe subjektivizmin. Për ta thënë thjesht, relativizmi thotë se nuk ka standarde objektive, prandaj në librin e tij, që pati një ndikim të madh, “The Closing of the American Mind”, (“Mbyllja e Mendjes Amerikane”), i botuar më 1988-n, Allan Bloom pohoi: “Një profesor mund të jetë i sigurt vetëm për një gjë. Pothuajse çdo student që hyn në universitet beson, ose thotë se beson, se e vërteta është relative”.<sup>22</sup> E megjithatë, relativizmi shpërbëhet sapo përpiqemi të shqyrtojmë nënkuptimet e tij. Ashtu si nxjerr në pah autori modern Roger Scruton: “Një shkrimtar që thotë se nuk ka të vërteta apo që e gjithë e vërteta është ‘thjesht negative’, po ju kërkon që të mos ta besoni atë vetë. Prandaj mos e besoni”.<sup>23</sup>

Një lloj i relativizmit thotë se moralshmëria u zhvillua gjatë rrjedhës së kohës si një lloj kontrate shoqërore që synonte të arrinte përfitimin më të madh për numrin më të madh të njerëzve, por historia gëlon nga shembujt e sunduesve, politikanëve, shkencëtarëve dhe të tjerëve që kanë bërë gjëra të tmerrshme në emër të këtij parimi. Hitleri do ta mbështeste menjëherë këtë ide. Eliminimi që i bëri mbi gjashtë milionë hebrenjve, ciganëve, zezakëve dhe “inferiorëve” të tjerë në Holokaustin famëkeq u motivua nga vendosmëria e tij “për ta çliruar Gjermaninë nga gabimet e marra dhe degraduese të moralshmërisë” dhe për të zhvilluar një racë superiore, ku do të garantohej pjesa më e madhe e përfitimit më të madh. Terroristët që vranë afërsisht 3 000 njerëz në sulmin e urryeshëm mbi Shtetet e Bashkuara, më 11 shtator 2001, ishin të bindur se si martirë jo vetëm që do të fitonin një vend të shquar në parajsë, por që po i shërbenin një çështjeje nga e cila do të përfitonte gjithë njerëzimi.

Subjektivizmi i çon gjërat një hap logjik më tej dhe thotë se, në mungesë të standardeve objektive, çdo individ është i aftë të vendosë norma etike të vlefshme. Në një debat në radio, më 1948-n, prifti jezuit Frederick Copleston pyeti filozofin britanik ateist Bertrand Russell: “Çfarë arsyeje jep për të dalluar mes së mirës dhe së keqes ose si e sheh dallimin midis tyre?”. Russell u përgjigj: “Nuk kam ndonjë arsye më shumë sesa kam kur dalloj midis blusë dhe të verdhës. Çfarë arsyeje jap për të dalluar midis blusë dhe të verdhës? Mund ta shoh se janë ndryshe”. Kur Copleston vazhdoi: “Mirë, kjo është një arsye e shkëlqyer, jam dakord. Ti e dallon blunë dhe të verdhën nëpërmjet të parit, por nëpërmjet cilës aftësi dallon të mirën dhe të keqen?”. Russell u përgjigj: “Nëpërmjet ndjenjave të mia”. Por nëse çdo individ justifikohet në ndjekjen e ndjenjave të tij apo të saj kur vendos për çështje të moralshmërisë, askush nuk i detyrohet moralisht ndonjë tjetri.

I çuar në konkluzionin e vet logjik, subjektivizmi i barazon zgjedhjet morale me përzgjedhje të artikujve nga menyuja e një restoranti: biftek apo salmon, karrota apo lulelakër, verë apo ujë? Kur pohon “parimet morale që sundojnë sjelljen tonë janë rrënjësor në zakon dhe traditë, ndjenjë dhe modë”,<sup>24</sup> humanisti bashkëkohor Paul Kurtz mendon se kështu ndodh, por nuk është e vështirë të tregosh se, duke e privatizuar etikën në këtë mënyrë, e bën atë recetë për kaos social. Nëse moralshmëria është plotësisht subjektive, askush nuk mund të dënojë atë që një tjetër bën, sepse madje edhe ajo që konsiderohet shumë e pamoralshme nga gjithë të tjerët, mund të konsiderohet e moralshme nga personi në fjalë.

Autori i mirënjohur Ernest Heminguej dikur shkroi: “E moralshme është ajo pas së cilës ti ndihesh mirë dhe e pamoralshme është ajo pas së cilës ndihesh keq”,<sup>25</sup> por a mbetet e vërtetë kjo thënie pas përdhunimit që bën një gangster, apo kur një kriminel i ri sulmon një plakë në rrugë dhe i vjedh paratë në çantë për të ushqyer zakonet e tij për drogë? Pa dyshim që sulmuesit ndihen mirë më pas, por a përligjen veprimet nga ndjenjat e tyre? A mund të kënaqemi duke thënë se sulmet ishin të drejta për sulmuesit por jo për viktimat? Në dimrin e vitit 2005-2006, një njeri hyri me forcë në një shtëpi në veri të Anglisë, rrëmbeu një vajzë gjashtëvjeçare kur po bënte banjë dhe e përdhunoi para se ta linte të shtrirë lakuriq afër shtëpisë, kur temperatura ishte vetëm pak gradë mbi zero. Brenda një kohe të shkurtër, titujve të medias mbi këtë çështje iu shtuan edhe ato që tregonin për një vajzë trevjeçare, e rrëmbyer, e përdhunuar dhe që u gjet në një makinë të përplasur larg shtëpisë së saj. A mund të debatojë dikush se ajo që këta sulmues bënë nuk ishte relativisht por *absolutisht* e gabuar? Dhe nëse këto veprime ishin absolutisht të gabuara, ku e lë kjo argumentin se

nuk ka absolute morale? Personi që mohon absolutet morale qëndron pezull. Sipas fjalëve të thëna nga autori rus Fjodor Dostojevski: “Pa Perëndinë çdo gjë lejohet”.

## Të shkosh me rrymën?

Një ide tjetër që ka pasur mbështetje të madhe vepron nën emrin e multi-kulturizmit. Në mbështjelljen e vet kjo thotë se asgjë nuk është jashtë fushës së veprimit të kulturës, e cila depërton në gjithçka që qeniet njerëzore mendojnë, bëjnë, krijojnë dhe besojnë, kështu që pohimet fetare, modelet filozofike, madje dhe lëvizjet shkencore, të gjitha shihen si “konstrukte shoqërore”. Për sa i përket parimeve etike, thuhet se këto janë të përcaktuara nga kultura bashkëkohore, pa ndonjë ligj superior që del mbi to.

Në një debat të mbajtur në Universitetin e Kalifornisë në Irvine, Gordon Stein, në atë kohë zëvendëspresident i Atheists United (Ateistët e Bashkuar) dhe i prezantuar si “një prej shkollarëve më të shquar të ateizmit në Amerikë”, shqiptoi se ç’do të thotë kjo: “Vlerat morale të njerëzve janë një akomodim që kanë bërë me mjedisin e tyre të veçantë dhe që ua kanë mësuar fëmijëve të tyre. Është një mekanizëm mbijetese . . . E keqja, me përkufizim, është në universin e një ateisti ajo që ul lumturinë e njerëzve. Ajo gjë është e keqe kur bën që më shumë njerëz të mos jenë të lumtur. Si e dimë këtë? Eh, ne nuk e dimë. Është një konsensus, ashtu si moralshmëria është në përgjithësi një konsensus”.

Fare lehtë mund të radhisim katër arsye se përse të lidhësh moralshmërinë me kulturën apo me një konsensus nuk është një pikë nga e cila mund t’ia fillosh.

Së pari, kur konsiderojmë çështje morale, si mund të jemi të sigurt se opinioni publik është më i mirë se opinioni personal? A garanton sasia cilësi? A mund të ndajmë të drejtën nga e gabuara duke ngritur dorën? Përse duhet që një grup individësh të ketë ndonjë autoritet moral mbi një person të vetëm që nuk arrin të bjerë dakord me përfundimet e tyre?

Së dyti, nëse kultura na kontrollon, si mund të pohojmë se disa janë superior ndaj të tjerëve nga ana morale? Nëse ligji moral reflekton pikëpamjen e pjesës më të madhe, apo të grupit më të fortë, në një shoqëri të caktuar, çfarë themi kur një shoqëri tjetër nuk bie dakord me detajet? Si mund të ketë një bazë kulturore për të zgjedhur mes kulturave? Një shkrimtar modern e bën të njohur dhe e shpjegon problemin: “Nëse një ligj është thjesht relativ për kulturën, atëherë, sigurisht, është e pamundur për një kulturë të gjykojë një tjetër; secila ka ligjin e vet dhe secili ligj justifikohet nga opinioni publik i njerëzve të vet.

Por kur vjen puna ne e dimë se kjo pikëpamje e ligjit është e gabuar. Në gjyqet e Nurembergut nazistët e akuzuar për krime lufte thanë se thjesht po zbatonin urdhrat dhe ligjet e qeverisë së Gjermanisë. Por kjo arsye u duk e rreme. Gjyqet e Nurembergut mbështeteshin në konceptin që ka një ligj më të lartë me anë të të cilit mund të viheshin në provë ligjet e Gjermanisë naziste”.

Së treti, çfarë themi kur pikëpamjet e një shoqërie mbi çështjet morale i nënshtrohen një ndryshimi radikal? Pika e mëparshme na jep një shembull të përsosur, sepse qeveria e tanishme gjermane i hedh poshtë me forcë parimet e ndjekura nga udhëheqja e Gjermanisë naziste. A ka ndonjë arsye krejt kulturore se përse mund të lavdërojmë një dhe të dënojmë tjetrën?

Së katërti, disa prej njerëzve më të nderuar në histori janë ata që kanë hedhur poshtë kulturën e kohës së tyre dhe kanë luftuar me mish e shpirt kundër disa praktikave, derisa u bënë ndryshime radikale. Vetëm në shek. XIX-të fushata kundër skllavërisë e William Wilberforce, fillimi i reformës së burgjeve nga Elisabeth Fry dhe përpjekjet e kontit të Shaftesbury në mbështetje të klasave punëtore dhe të të sëmurëve mendorë ishin shembuj të atyre që nuk pranonin të “shkonin me rrymën” dhe përmbysën praktika që kishin qenë të pranueshme për shekuj.

Duke shkruar si “një hebreje agnostike, pa ndonjë arsye fetare personale, Janet Daley i ra në të kur u tha lexuesve të saj të *“Daily Telegraph”*: “Është një gabim thelbësor logjik të mendosh se mund të zgjedhësh mes kulturave, kur një shoqëri e caktuar, me programin e vet moral të qartë, është e vetmja pajisje që kemi për të bërë zgjedhje sociale. Nëse të gjithë kanë të drejtë, atëherë asnjë nuk ka të drejtë”.<sup>27</sup>

## Alternativa

Deri tani kemi parë tri burime teorikisht të mundshme të “ligjit moral brenda” natyrës, zgjedhjes personale dhe kulturës mbizotëruese që kishte Kanti. Këto të gjitha përshtaten në një botëkuptim që e eliminon Perëndinë, por asnjë nuk përshtatet në atë që ne dimë rreth ligjit moral. Ata që e mohojnë Perëndinë, me siguri mund të bëjnë gjëra që do të pohonin se janë “të mira”, por ata nuk mund të ofrojnë shpjegim logjik se pse këto veprime mund të shpjegohen në këtë mënyrë. Përse ndershmëria është më e mirë se pandershmëria, përulësia më e mirë se krenaria, pastërtia më e mirë se papastërtia apo dashuria më e mirë se urrejtja?

Tashmë kemi përmendur përgjigjen e zakonshme të dhënë nga humanistët dhe të tjerë që mendojnë si ata, që moralshmëria është një çështje vetëmbrojtjeje

dhe se ne mund të vendosim se çfarë është “e mirë” në bazë të asaj që nxit përfitimin më të madh të numrit më të madh të njerëzve, por ky argument nuk qëndron përballë gjykimit të shëndoshë dhe përvojës; shpesh ushtrojmë gjykim mbi çështje morale që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me vetëmbrojtjen tonë apo me mirëqenien e njerëzve të tjerë. Në mungesë të vlerave absolute, nuk ka ndonjë bazë mbi të cilat mund të bëjmë gjykime morale rreth ndonjë gjëje apo ndonjë njeriu.

Tani kemi parë se një bazë e qëndrueshme për vlera morale duhet të hedhë rrënjë në diçka tjetër veç natyrës, parapëlqimeve personale apo kulturës. Kjo na lë vetëm me një alternativë tjetër, një bazë mbi të cilën mund të bëhen gjykime morale, prandaj disa gjëra mund të jenë të vërteta rreth saj.

Së pari, duhet të jetë *transhendente*. Vështirë se na duhet ta debatojmë këtë pikë, por, nëse dallimi mes së mirës dhe së keqes është radikal e i vërtetë dhe nuk ka ndonjë bazë natyrore për ta përkufizuar atë, atëherë duhet të ketë një mbinatyrore, tërësisht e pandikuar nga llogaritë njerëzore, të cilat mund të ndryshohen lehtësisht nga vetinteresi apo ndonjë motiv tjetër i vënë në pikëpyetje. C. S. Lewis e sqaroi në mënyrë të shkëlqyer këtë kur kujtonte kohën që ishte ateist: “Argumenti im kundër Perëndisë ishte se universi dukej kaq mizor dhe i padrejtë. Por nga e kisha marrë këtë ide të *së drejtës dhe të së padrejtës*? Një njeri nuk e quan një vijë të shtrembër nëse nuk ka ndonjë ide për një vijë të drejtë. Me çfarë po e krahasoja universin kur e quajta të padrejtë? Nëse e gjithë shfaqja ishte e keqe dhe e pakuptimtë nga koka deri te këmbët, po ta themi kështu, përse unë, që mendohej të isha pjesë e shfaqjes, e gjeja veten në një reagim aq të dhunshëm kundër saj? . . . Kështu, në po atë veprim përpjekjeje për të vërtetuar se Perëndia nuk ekzistonte, me fjalë të tjera, se i gjithë realiteti nuk kishte kuptim, isha i detyruar të supozoja se një pjesë e realitetit, kryesisht ideja ime për drejtësinë, ishte plot kuptim. Si rrjedhim, ateizmi na del të jetë shumë i thjeshtë. Nëse universi nuk ka kuptim, ne kurrë nuk duhej të zbulonim se nuk ka kuptim.”<sup>28</sup>

Së dyti, duhet të jetë *e përsosur*, përndryshe do të ishte e paaftë të kalojë gjykim të pagabueshëm mbi çështjet morale. Zemra ime është në një gjendje të tillë, saqë ka nevojë për t’u kontrolluar rregullisht, ku të dhënat e detajuara të EKG-së varen nga një shkallë reference absolute që jepet nga pajisja që përdor doktori. Gjatë vizitës së fundit ai kishte pajisje të re, por teknologjia e saj mbresëlënëse do të kishte qenë e padobishme pa ndonjë standard absolut reference.

Së treti, duhet të jetë *e pandryshueshme*, në asnjë mënyrë e ndikuar nga luhatjet në konceptimet e njohura të çështjeve morale. Do të ishte e pamundur të luaje lojën e moralit nëse shtyllat e portës do të lëviznin vazhdimisht!

Këto tri kërkesa duken të qarta dhe të dukshme, por ka një tjetër; duhet të jetë *personale*. Ndërgjegjja na tregon se ka gjëra që duhet t'i bëjmë dhe gjëra që nuk duhet t'i bëjmë. Fjala “duhet” në këtë rast ka kuptimin “i detyrohesh” dhe flet për detyrim moral. Megjithatë, detyrimet morale përfshijnë marrëdhënie personale. Atë që nënkuptoj këtu po e ilustruj me faktin që ne të gjithë i nënshtrohemi ligjit të rëndesës, por nuk kemi detyrime morale që t'i bindemi atij. Standarde absolute kërkojnë detyrime absolute dhe për arsye që sapo i kemi parë detyrimet absolute duhet të lidhen me një realitet që është transhendent, i përsosur, i pandryshueshëm dhe personal.

## Katër nga katër

Kjo mund të sugjerojë se të gjesh një bazë të shëndoshë për “ligjin moral në brendësi” është shumë e vështirë, por Perëndia i shfaqur në Bibël i plotëson të katërta kërkesat e domosdoshme.

### Ai është transhendent

Fjalët që hapin Biblën e bëjnë këtë të qartë si drita: “Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën” (Zanafilla 1:1). Kjo na tregon se Perëndia është Krijuesi i pakrijuar i gjithë realitetit jashtë vetes së tij, nga engjëjt deri tek atomet, nga elefantët tek energjia, nga titaniumi te koha, nga delfinët tek ADN-ja, nga yjet te hapësira në të cilën i vendosi ata, dhe këtë e bëri nga asgjëja. Ashtu si shprehet Bibla: “Me anë të besimit ne kuptojmë se bota është ndërtuar me fjalën e Perëndisë, saqë ato që shihen nuk u bënë prej gjërave që shihen” (Hebrenjve 11:3). Perëndia është i dallueshëm e i veçuar nga i gjithë universi dhe nga çdo gjë në të, dhe nuk mund të kufizohet në hapësirë, aq sa nuk mund të matet nëpërmjet kohës. Ai është absoluti dhe gjithçka tjetër është relative. Bibla i redukton të gjitha këto të vërteta në vetëm pesë fjalë, kur thotë se ai “ngrihet sovran mbi gjithçka” (1 Kronikave 29:11).

### Ai është i përsosur

Përsosmëria e Perëndisë është e stamposur kudo në Shkrim. Ai është “përsosmëri e bukurisë” (Psalmi 50:2); “rruga e tij është e përsosur” (2 Samueli 22:31); “vepra e tij është e përsosur” (Ligji i Përtërirë 32:4); ai është “i përsosur në njohuri” (Jobi 36:4) dhe “ligji i Zotit është i përsosur” (Psalmi 19:7). Perëndia nuk ka të

meta morale, dobësi, papërsosmëri apo cene. Ai ka, ashtu siç e ka quajtur një shkollar modern, “madhështi morale të plotë e unike” dhe e përkufizon të mirën dhe të keqen *nëpërmjet asaj që ai është*. Çdo gjë që përplaslet me përsosmërinë e Perëndisë është, si rezultat, e keqe dhe e gabuar. E megjithatë, Perëndia shkon përtej përsosmërisë morale. Bibla flet për “shkëlqimin e shenjtërisë së tij” (1 Kronikave 16:29) dhe për “shkëlqimin e lavdishëm” (Psalmi 145:5). Ashtu si thotë C. S. Lewis: “Një njeri mund ta zvogëlojë lavdinë e Perëndisë, po aq sa një i çmendur mund ta shuajë diellin duke shkarravitur ‘errësirë’ në muret e qelisë së tij”.<sup>29</sup>

### Ai është i pandryshueshëm

Sipas fjalëve të Biblës, ai “nuk ka ndërrim dhe as hije ndryshimi (Jakobi 1:17). Vetëm ai mund të thotë me të vërtetë: “Unë jam Zoti, nuk ndryshoj” (Malakia 3:6). Në natyrë çdo gjë është në një gjendje të vazhdueshme ndryshimi, ndërsa si qenie njerëzore jo vetëm që plakemi me kalimin e çdo minute, por vazhdimisht rishohim mundësitë dhe opinionet tona, parapëlqimet dhe pozitat tona. Në një kontrast verbues, Perëndia është plotësisht i besueshëm dhe pandryshueshmërisht i qëndrueshëm në gjithçka që mendon, thotë dhe bën.

### Ai është person

Kur ateisti i Oksfordit don Peter Atkins u tall me besimtarët që besonin në “këtë gjënë e panjohur atje lart, saqë duhet të kalojmë kohën duke i qëndruar lepe-peqe”,<sup>30</sup> ai tradhtoi paditurinë e tij të thellë për atë që thotë Bibla. Në vend që ta përkufizojë Perëndinë si pluhur kozmik, energji atmosferike apo ndonjë lloj “fuqie më të lartë” a ndikim, Bibla na tregon se ai është i gjallë në mënyrë dinamike. Ai mendon, kujdeset, jep, bën (dhe mban) premtime. Ai është përshkruar si “i mirë” (Psalmi 25:8), “besnik” (Ligji i Përtërirë 7:9), “i mëshirshëm dhe zemërbutë” (Psalm 103: 8), atij i “përket mëshira dhe ndjesa” (Danieli 9:9) dhe “plot dhembshuri” (Joeli 2:13), karakteristika që nuk mund t’i vishen karikaturës së Peter Atkins. Teologu modern Peter Moore nuk e tepron kur shkruan: “Fakti themelor rreth universit është një Perëndi person”.<sup>31</sup> Francis Collins, Drejtor i Institutit Kombëtar të Kërkimit të Gjenomit Njerëzor bie dakord: “Ligji moral, i cili sfidon shpjegimin shkencor, është pikërisht ai që dikush mund të presë të gjejë po të kërkonte për ekzistencën e një Perëndie person i cili kërkoi marrëdhënie me njerëzimin”.<sup>32</sup>

Të përpiqesh të jetosh një jetë morale në mënyrë të ndërgjegjshme ndërkohë që mohon ekzistencën e Perëndisë, është si të ngasësh makinën me sy mbyllur;

nuk ka mënyrë të tregosh se në cilin drejtim po shkon. Me Perëndinë në qendër të botëkuptimit tënd, vendi dhe qëllimi i ndërgjegjes bëhet i qartë. Madje edhe ata që e mohojnë ekzistencën e Perëndisë e kanë ligjin e tij “të shkruar në zemrat e tyre” (Romakëve 2:15). Ashtu siç e përshkruan parafrazimi i J. B. Phillips: “Ata tregojnë se kanë një ligj në vetvete, sepse demonstrojnë efektin e një ligji që vepron në zemrat e tyre. Ndërgjegjet e tyre mbështesin ekzistencën e një ligji të tillë, sepse ka diçka që dënon ose miraton veprimet e tyre” (Romakëve 2:14-15). Ndërgjegjia është gjurma e Perëndisë në zemrat e njerëzve, duke na dhënë secilin prej nesh një vetëdije morale të qenësishme.

Por Bibla shkon madje më tej dhe thotë (duke cituar parafrazimin përsëri): “Mund të jemi të sigurt se e gjithë kjo do të merret parasysh në Ditën e Gjykimit të Vërtetë, kur Perëndia do të gjykojë jetët e fshehta të njerëzve . . .” (Romakëve 2:16, J. B. Phillips).

Ka një politikë të lashtë publike në çështje ligjore që thotë: “*Ignorantia legis neminem excusat*” (“Mosnjohja e ligjit nuk është justifikim”). Kjo do të thotë se një person që nuk është në dijeni të një ligji mund të mos i shpëtojë përgjegjësisë që ka shkelur atë ligj thjesht sepse ai ose ajo nuk ishte në dijeni të përmbajtjes së tij. Bibla thotë pothuajse të njëjtën gjë kur pohon se të shkelësh ligjin e Perëndisë e bën personin në fjalë fajtor dhe e lë pa përgjigje ndaj Perëndisë në ditën e gjykimit përfundimtar, pavarësisht se sa shumë apo pak di individi në fjalë për atë që thotë ligji i Perëndisë. Ata që do të pretendonin se kjo është e padrejtë po harrojnë se, sa herë që japin gjykim mbi sjelljen e tyre apo mbi atë të të tjerëve, ata po pohojnë se të dyja pjesët janë nën autoritetin e një kodi moral transhendent. Ashtu siç e pranon lirshëm ateisti dhe shkollari modern Richard Taylor: “Koncepti i detyrimit moral është në mënyrë të pakuptueshme larg idesë së Perëndisë. Fjalët mbeten, por kuptimi i tyre ka ikur”.

## Pyetja më e madhe

Ka një kuptim në të cilin pyetja “A mund të jemi të mirë pa Perëndinë” nuk është një fillim, sepse pa një bazë transhendente, të përsosur, të pandryshueshme dhe personale për moralshmërinë nuk kemi mënyrë për të përkufizuar të drejtën nga e gabuara, dhe vetëm Perëndia i ka të gjitha këto cilësi. Të pranosh Perëndinë si pikë referimi vendimtare për të përcaktuar absolute morale ngre një pyetje, që, me siguri, e përdor kushdo që mendon seriozisht rreth moralshmërisë: “A mund të jemi mjaft të mirë për Perëndinë pa Perëndinë?”. Duke studiuar dy raste të regjistruara në Bibël do të marrim një përgjigje të qartë ndaj pyetjes.

## Rast studimi 1

Ky shfaqet në formën e një shëmbëlltyre që Jezui ua tregoi disa njerëzve që pretendonin se ishin të drejtë dhe i përbuznin të tjerët” (Luka 18:9). Ja se çfarë shkruhet atje:

Dy njerëz u ngjitën në tempull për t’u lutur: njëri ishte farise dhe tjetri tagrambledhës. Fariseu rrinte në këmbë dhe lutej në vetvete kështu: “O Perëndi, të falënderoj që nuk jam si njerëzit e tjerë, grabitqarë, të padrejtë, kurorëshkelës dhe as si ai tagrambledhës. Unë agjëroj dy herë në javë dhe paguaj të dhjetën e gjithçkaje që kam”.

Kurse tagrambledhësi rrinte larg dhe as që guxonte t’i çonte sytë drejt qiellit; por rrihte kraharorin e vet duke thënë: “O Perëndi, ji i mëshirshëm ndaj mua mëkatarit”.

Dhe unë po ju them se ky dhe jo tjetri u kthye në shtëpinë e vet i shfajësuar; sepse kushdo që lartohet, do të ulet dhe kush ulet, do të lartohet” (Luka 18:10-14).

Tempulli i madh në Jerusalem ishte pika qendrore e fesë së kombit, dhe ja dy njerëz që po shkonin të luteshin për të kërkuar fytyrën e Perëndisë dhe të njihnin bekimet e tij në jetët e tyre.

I pari ishte një *farise*. Nga gjithë sektet judeje, farisenjtë ishin më radikalët. Ligji i Perëndisë i ishte dorëzuar kombit jude që nga koha e Moisiut, por kishte shumë që nuk e respektonin atë si duhej. Farisenjtë, një parti fetare e formuar në kohën midis Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re, reagonin fuqishëm ndaj këtij qëndrimi, prandaj synonin bindje të përpiktë jo thjesht ndaj ligjit të Perëndisë në përgjithësi, por, gjithashtu, edhe ndaj një mase rregullash dhe rregulloresh që i ishin shtuar atij nga një radhë shkollarësh. Në të vërtetë, farisenjtë shpesh i jepnin më shumë rëndësi këtyre, sesa vetë ligjit, dhe arritën deri aty sa të besonin se bindja strikte ndaj tyre do të bënte që të vinte Mesia (“i Vajosuri”) dhe do të garantonte pranimin e tyre në mbretërinë e Perëndisë. Edhe pse mes tyre përfshiheshin njerëz me karakterin dhe integritetin më të lartë, Dhiata e Re, zakonisht, jep një opinion shumë të keq për ta, duke i dënuar shpesh për vetëdrejtësinë dhe hipokrizinë e tyre.

I dyti ishte një *tagrambledhës*. Në shoqërinë moderne nëpunësit e taksave mund të jenë modele të integritetit, por duket se ky njeri nuk i përkiste këtij kalibri. Ata që ishin punësuar nga romakët pushtues ishin lehtësisht në gjendje të mashtronin me shifrat dhe të mbanin ca parë për veten e tyre. Tagrambledhësit judenj konsideroheshin tradhtarë nga bashkëkombësit e tyre, prandaj këtij turpi i shtoej reputacioni i tyre për pandershmëri duke i bërë ata të urreyer sa

s'ka si grup. Ata përçmoheshin kaq shumë, saqë Dhiata e Re i bën ata bashkë me të padëshirueshëm të tjerë në shprehjen "tagrambledhës dhe "mëkatarë" (p.sh. Mateu 9:11). Po t'i ofronin sinagogës së tyre një dhuratë, ajo nuk do të pranohej.

I pari që u lut ishte fariseu, i cili "rrinte në këmbë dhe lutej në vetvete kështu: 'O Perëndi, të falënderoj . . .'. Të falënderosh Perëndinë tingëllon një fillim i mirë, por shkatërrohet nga fakti që ajo që pason është një ushtrim në vetëpërgëzim, ku Perëndia nuk përmendet më. "Nuk jam si të tjerët" na tregon se ai mendonte se ishte më i mirë se gjithë të tjerët dhe vazhdon të përçmojë tri grupe në veçanti, "grabitqarët", "të padrejtë" dhe "kurorëshkelësit". "Grabitqarë" mbështetet në fjalën greke për çengelin që piratët përdornin për të hipur në një anije dhe përshkruante grabitësit lakmitarë të përgatitur për të bërë gjithçka për të mbushur xhepat.

"Të padrejtë" ishin njerëz jo të ndershëm kur kishin çështje me të tjerët. Thuhet se Diogjeni cinik grek njëherë eci nëpër rrugët e Athinës duke mbajtur një qiri të ndezur në mes të ditës. Kur dikush e pyeti se çfarë po bënte, ai u përgjigj: "Po kërkoj një njeri të ndershëm". Shumë pak ndryshim ka ndodhur: në politikë, industri, biznes, sport dhe marrëdhënie familjare, kush mund të pohojë të jetë plotësisht i ndershëm në fjalët dhe veprat e tyre?

Kuptimi i "kurorëshkelësve" është përsosmërisht i drejtpërdrejtë. Në shoqërinë pagane, të paktën, qëndrimet ndaj sjelljes seksuale janë po aq të lirshme sa janë edhe në ambiente të ngjashme sot, por farisenjtë kishin një pikëpamje shumë të ndryshme dhe e gjykonin kurorëshkeljen si një mëkat degradues dhe të neveritshëm. Fariseu pohoi se nuk ishte as lakmitar, as i pandershëm dhe as imoral (dhe nuk kemi arsye ta vëmë në pikëpyetje pohimin e tij). Duke parë njeriun tjetër në tempull, ai me krenari shtoi një shënim të fundit që "nuk ishte as si ai tagrambledhës", reputacioni i të cilit kundërmonte.

Fariseu atëherë shtoi argumente të tjera për rastin e tij, duke i kujtuar Perëndisë dy mënyra specifike në të cilat ai besonte se meritonte shpërblim: "Unë agjëroj dy herë në javë dhe paguaj të dhjetën e gjithçkaje që kam". Të agjërosh (në kuptimin që të rrish pa ushqim për një kohë të caktuar) nuk urdhërohet specifikisht në ligjin e Dhiatës së Vjetër, megjithëse judenjtë agjëronin në *Yom Kippur* (Ditën e Shlyerjes), që ishte një kohë e përvitshme vetëshqyrtimi shpirtëror. Më vonë, vihej re se agjërimi bëhej katër herë në vit, por fariseu nuk ishte i kënaqur me këtë dhe rrinte pa ushqim dy herë në javë. E dhjeta (t'i kushtojë një të dhjetën e të mbjellave dhe bagëtive Perëndisë) ishte dekretuar në ligjin e Dhiatës së Vjetër (p.sh. Levetiku 27:30-32), por fariseu

krenohej se shkoi më tej dhe hiqte mënjane për shërbesën e Perëndisë dhjetë për qind nga të gjitha të ardhurat e tij.

## Gabimi fatal

Tani vjen çasti vendimtar: ky njeri u largua nga tempulli i refuzuar nga Perëndia dhe i dënuar! Çelësi për ta kuptuar këtë është të kujtosh se Jezui ua tregoi historinë atyre “që i besonin drejtësisë së tyre”. Fariseu shkoi në tempull për t’u lutur, por “lutja” e tij nuk përbëhej nga gjë tjetër veçse një rënije të borisë së tij nëpërmjet recitimit të virtyeteve të tij dhe duke menduar se ato do të mjaftonin që të pranohej nga Perëndia. Por ai po bënte një gabim tragjik dhe thelbësor, sepse Bibla e bën të qartë si drita se askush nuk mund të jetë në rregull me Perëndinë “nëpërmjet veprave të ligjit” (Galatasve 2:16), dhe përcakton katër arsye të qarta përse është kështu.

Së pari, “ligji është frymëror” (Romakëve 7:14). Ai shkon më thellë se fjalët dhe veprat tona; gjykon mendimet tona, motivet dhe dëshirat. Perëndia kërkon të vërtetën “që qëndron në thelb” (Psalmi 51: 6) dhe jo thjesht në gjërat që mund të shohin e dëgjojnë të tjerët. Fjalët dhe veprimet tona mund të duken mirë, por a do të ishim po aq të lumtur nëse njerëzit shohin çfarë ndodh në zemrat dhe mendjet tona?

Së dyti, “ligji i Perëndisë është i përsosur” (Psalmi 19:7), dhe personit që synon të jetë në rregull me Perëndinë, duke mbajtur urdhërimet e tij, do t’i duhej të zbatonte secilin prej tyre. Standardi i kërkuar është përsosmëri, prandaj çdo gjë që nuk ia arrin kësaj do të thotë dështim dhe ndëshkim.

Së treti, kjo do të thotë se edhe një mëkat mjafton që ta dënojë një person. Ne nuk kemi mëkatuar të gjithë në të njëjtën mënyrë ose në të njëjtën masë apo me të njëjtën shkallë kuptueshmërie të asaj që po bënim, por “të gjithë kanë mëkatuar dhe kanë rënë nga lavdia e Zotit” (Romakëve 3:23), prandaj edhe një mëkat do të mjaftonte për të na dënuar.

Së katërti, ligji i Perëndisë nuk u dha që të na bënte të drejtë me Perëndinë, por të na tregonte se nuk ishim të drejtë! Sipas fjalëve të Biblës, “me anë të ligjit në fakt arrihet njohja e mëkatit” (Romakëve 3:20). Ligji i Perëndisë mund të diagnostikojë mëkatin, por nuk mund të çlirojë ndonjë prej tij. Ai mund të zbulojë mëkatin, por jo ta shërojë atë. Mund t’ju tregojë se jeni larg Perëndisë, por jo t’ju afrojë më shumë me të. Fariseu nuk arriti të kuptonte ndonjë prej këtyre katër të vërtetave të mëdha. A po bëni të njëjtin gabim?

Tani e ka radhën tagrambledhësi për t’u lutur, por, edhe para se të thotë ndonjë fjalë, mund të themi se i gjithë qëndrimi i tij është shumë i ndryshëm

nga ai i fariseut. Ai “rrinte larg”, edhe pse brenda caqeve të tempullit, por jo në qendër ku do të vihej re nga adhuruesit e tjerë. Ai “as që guxonte t’i ngrinte sytë drejt qiellit”, por uli kokën si shenjë se po vinte para një Perëndie të shenjtë, pa veshur një shfaqje të jashtme për t’i bërë përshtypje atyre që shikonin. Së fundi, ai “rrihte kraharorin e vet”. Koha e foljes këtu do të thotë se tagrambledhësi vazhdonte të rrihte kraharorin, shenjë e një dhimbjeje të madhe, keqardhjeje dhe dëshpërimi. Pastaj vjen lutja e tij: “Perëndi, ki mëshirë për mua mëkatarin”. Të dy burrat besonin se i përkisnin klasës së tyre, por për arsye shumë të ndryshme. Ndërsa fariseu krenohej se ishte *më i mirë* se gjithë të tjerët, tagrambledhësi pohonte se ishte *më i keq* se gjithë të tjerët. Ai e shihte veten si fajtor, i humbur dhe i pashpresë, pa asnjë fije të mire që do t’i jepte atij lavdërim para Perëndisë, e që meritonte vetëm zemërimin dhe gjykimin e tij.

Në këtë gjendje ai lutet vetëm për një gjë, por që ishte gjëja që kishte më tepër nevojë se çdo gjë tjetër, mëshirën e Perëndisë. Ai i kërkoi Perëndisë që ta hiqte zemërimin e tij të drejtë prej tij, në mënyrë që ai të mund të falej, të ripërtërihej dhe të pranohej nga Perëndia, por e kuptoi që kjo mund të ndodhte vetëm nëse e hidhte veten plotësisht në mëshirën e Perëndisë. Lutja e tij është me të vërtetë një përmbledhje e njëres prej atyre të ofruara nga Davidi, mbret i Izraelit, shekuj më parë:

Ki mëshirë për mua, o Perëndi,  
sipas mirësisë sate;  
për dhembshurinë që ke fshiji të ligat që kam bërë.  
Më pastro tërësisht nga paudhësia ime  
dhe më pastro nga mëkati im,  
sepse i pranoj të ligat që kam bërë,  
dhe mëkati im më rri gjithnjë përpara...  
O Perëndi, krijë tek unë një zemër të pastër

(Psalmi 51:1-3,10)

Nëse lutja e tagrambledhësit ishte e ndryshme nga ajo e fariseut, po ashtu ishte edhe rezultati i saj, sepse Jezui tha: “Ky dhe jo tjetri u kthye në shtëpinë e vet i shfajësuar”. Fariseu solli para Perëndisë një bulletin lajmesh të arritjeve të tij; tagrambledhësi solli një zemër të thyer. Fariseu i ra borisë; tagrambledhësi rrahu kraharorin e tij dhe Perëndia, që “u kundërvihet mendjemëdhenjve dhe u jep hir të përlulurve” (Jakobi 4:6) u përgjigj sipas lutjes. Tagrambledhësi u largua nga tempulli “i shfajësuar”, me një përgjigje ndaj lutjes, me falje të mëkateve dhe në paqe me Perëndinë. Fariseu u largua nga tempulli ashtu si hyri, i hedhur

poshtë dhe i dënuar. E gjithë historia ilustron fuqishëm të vërtetën biblike se, “kush do të lartësojë veten, do të poshtërohet; dhe kush do të përulë veten, do të lartësohet” (Mateu 23:12). Ajo gjithashtu hedh dritë mbi përgjigjen ndaj pyetjes “A mund të jemi mjaft të mirë për Perëndinë pa Perëndinë?”. Do t’i kthehemi kësaj pasi të kemi shqyrtuar një rast tjetër.

## Rast studimi 2

Rasti i dytë i studimit është i një ekstremisti fetar me emrin Saul. Duke bashkuar fragmente të dëshmisë në dispozicion të origjinës së tij, dimë se ai lindi në Tars, një qytet turk në grykëderdhjen e lumit Sindi në detin Mesdhe. I gjendur aty ku kryqëzoheshin disa rrugë të rëndësishme tregtie, Tarsi ishte një qendër e rëndësishme urbane me një komunitet të konsiderueshëm hebrenjsh dhe thuhej se ishte në konkurrencë me Athinën e Aleksandrinë në pasionin e vet për arsimimin dhe filozofinë. Ishte gjithashtu një vatër idesh fetare dhe shtëpi për atë që është quajtur “një varg marramendës perëndish dhe besimesh”.

Edhe pse nga zanati ishte “çadërbërës” (Veprat 18:3), dimë gjithashtu se arsimimi më i lartë i tij përfshinte ca kohë në Jerusalem, ku, si student i Gamalielit, një doktor i shquar i ligjit jude, ai ishte “edukuar me përpikmërinë e ligjit të etërve tanë” (Veprat 22:3). (Më vonë, në jetën e tij ky shkollor i shquar i shtoi emrit të tij origjinal “Saul” emrin grek “Pal”, prandaj, qysh atëherë, “Pal” është emri me të cilin njihet).

Në fjalët e shkruara kishës së hershme të krishterë në Filipi, në anën verilindore të Greqisë, ai na jep rastin e dytë të studimit që fillon me këto fjalë:

Megjithëse unë kam përse të besoj edhe në mishin; nëse ndonjë mendon se ka përse të besojë, unë kam akoma më shumë: u rrethpreva të tetën ditë, jam nga kombi i Izraelit, nga fisi i Beniaminit, hebre nga hebrenj dhe sipas ligjit farise, sa për zellin, përndjekës i kishës; për sa i përket drejtësisë, që është në ligj, i paqortueshëm. (Filipianëve 3:4-6).

Është e qartë se ai po u referohet njerëzve që mbanin nocionin e njohur se do të ishin në rregull me Perëndinë me anë të statusit të tyre fetar apo përpjekjeve të tyre. Ata vendosin “besimin në mish” dhe besojnë se, duke i shtuar prejardhjes së tyre veprimet shpirtërore e morale, mund të ishin të sigurt se Perëndia do t’i pranonte ata dhe se në fund të jetës atyre do t’u garantohej një vend në qiell.

Pali e sulmon hapur arrogancën e tyre dhe fillon duke thënë se, çfarëdo arsyeje që mund të kenë për të bërë një pohim të tillë, ai kishte më shumë, dhe pastaj e mbështet këtë duke radhitur shtatë faktorë të mëdhenj në të cilët kishte

besuar dikur. Unë do t'u ndryshoj pak rendin, në mënyrë që ata të rrjedhin pak më lehtë në mënyrën moderne të të menduarit tonë.

1. *"Nga kombi i Izraelit"*. Shtytja e parë e Palit është të thotë se kishte lindur si jude. Ky ishte një "plus" jashtëzakonisht i madh në mendjet e njerëzve të cilëve po u shkruante. Në terma fetarë, judenjtë e mendonin veten një racë të veçuar nga pjesa tjetër e popullsisë së botës, të përzier së bashku si "johebrenj" apo "grekë" (madje edhe ata që nuk kishin lidhje me grekët). Ajo që i dallonte judenjtë nga pjesa tjetër e njerëzimit në botën e lashtë ishte se vetëm ata besonin në një Perëndi. Romakët dhe grekët kishin nga një panteon hyjnish, ndërsa kombet dhe fiset e tjera adhuronin idhuj të panumërt që kishin shpikur. Pali hodhi poshtë gjithë këtë idhujtari e paganizëm dhe e bëri të qartë se kishte prejardhje të pastër izraelite.

2. *"Nga fisi i Beniaminit"*. Pasi ka pohuar avantazhin kombëtar, Pali tani i referohet avantazhit që kishte nga të parët e tij. Pas vdekjes së mbretit Solomon në vitin 930 para Krishtit, një luftë civile ndau "mbretërinë e bashkuar" të judenjve në dhjetë fise veriore dhe dy fise jugore. Fiset veriore, zakonisht të quajtura "Izrael", u sunduan nga një varg prej nëntëmbëdhjetë mbretërish, pothuajse të gjithë e çuan Izraelin gjithnjë e më shumë në paqëndrueshmëri, imoralitet dhe idhujtari, derisa, më në fund, u fshi nga harta përgjithmonë. Dy fiset jugore, Juda dhe Beniamini (që zakonisht së bashku quheshin Juda), kishin një përzierje mbretërish, disa të mirë dhe disa të këqij, dhe zgjatën 140 vjet më shumë se Izraeli, para se të pushtoheshin nga babilonasit, nën mbretin Nebukadnetcar. Jerusalemi u rrafshua, tempulli i Solomonit, qendra madhështore e fesë së kombit u bë shkumb e hi dhe ajka e popullsisë u internua në Babiloni. Por mërgimi zgjati vetëm shtatëdhjetë vjet dhe nga mënyra e mrekullueshme se si u krijuan rrethanat populli i Judës u lejua të kthehej në shtëpi, të rindërtonte Jerusalemin, të rindërtonte tempullin dhe të rindërtonte strukturën fetare të kombit. Kjo pjesë e historisë mund të na duket e largët sot, por është e rëndësishme të mos e harrojmë atë për shkak të pohimit të Palit se vinte nga fisi i Beniaminit, njëri prej vetëm dy fiseve që i mbetën besnikë Perëndisë gjatë 300 viteve trazirë.

3. *"I rrethprerë të tetën ditë"*. Kjo mund të duket pa lidhje për johebrenjtë kur lexojnë këto fjalë tani, por në kohën e Palit ishte jashtëzakonisht domethënëse. Perëndia urdhëroi që Abrahami të rrethpritej, i pari dhe themeluesi i gjithë kombit jude, si shenjë të besëlidhjes në të cilën kishin hyrë me të. Ishte kusht për kombësinë e një judeu mashkull; ka vende në Bibël ku atyre që nuk e adhurojnë Perëndinë e vërtetë u referohen si "të parrethprerë" (p.sh. Ezekiel 31:18). Meshkujt e kthyer në besimin judaik rrethpriteshin në kohën që ktheheshin

në besim, por Pali nuk ishte i vonuar në besimin jude. Ai mund të tregonte për të qenit një hebre me gjak të pastër, duke qenë se ishte rrethprerë kur ishte tetëditësh, saktësisht siç ishte përcaktuar në besëlidhjen e parë me Abrahamin (Zanafilla 17:9-12).

4. *“Hebre nga hebrej”*. Tani Pali shkon edhe më thellë për të krijuar dokumentacionin e tij fetar dhe thotë se ishte “hebre nga hebrej”. Ai nuk ishte një i jashtëm i kthyer në besim, por që kishte lindur në një familje hebreje (judeje), ku prindërit e tij, fetarë të zellshëm, kishin mbajtur besimin, gjuhën dhe zakonet e tyre judeje, edhe pse jetonin në një vend të huaj. Ky ishte guri i themelit për këto dokumentacione mbresëlënëse trashëguese. Tani ai u kthehet atyre që kishte bërë për të ndërtuar në themelin e tyre.

5. *“Sipas ligjit, farise”*. Diku tjetër, Pali e nënvizon këtë duke thënë se nuk ishte vetëm farise, por “biri i një fariseu” (Veprat 23:6). Ai krenohej që i përkiste asaj që e quante “sekti më i fortë i fesë sonë” (Veprat 26:5) dhe që ishte “jashtëzakonisht i zellshëm për traditat e etërve të mi” (Galatasve 1:14). Ashtu siç e pamë në rastin e parë të studimit, farisenjtë i kushtonin rëndësi të madhe një numri rregullash dhe rregulloresh të imponuara në ligjin e Perëndisë në Dhiatën e Vjetër dhe besonin se bindja ndaj tyre ishte pasaporta për në mbretërinë e qiellit. Pali ishte i zhytur në këtë ide që mbizotëronte të menduarit e tij.

6. *“Për sa i përket drejtësisë, që është në ligj, i paqortueshëm”*. Kjo na tregon se Pali e zbatonte atë që mendonte. Ai ishte kaq i kujdesshëm në zbatimin e kornizës ligjore që shkollarët kishin imponuar mbi ligjin e Perëndisë, sa që ai sfidonte këdo që e kritikonte atë. Por ai shkoi edhe më tej.

7. *“Sa për zellin, përndjekës i kishës”*. “Kisha” ishte kisha e krishterë, themeluesi i së cilës, Jezui, i kishte denoncuar me zemërim farisenjtë për vetëdrejtësinë e tyre dhe mësoi se të jesh në rregull me Perëndinë varej nga hiri i Perëndisë dhe jo nga përpjekja e njeriut. Kjo i zemëroi farisenjtë dhe Pali ishte kaq i bindur se të ndiqje urdhrat e ligjit ishte e vetmja mënyrë për të qenë në rregull me Perëndinë, sa që ai hyri në një mision “kërko dhe shkatërro” kundër atyre që mendonin ndryshe. Ne e shohim atë “duke shfryrë kërcënime” (Veprat 9:1) kundër kishës së hershme, merrte autorizime nga autoritetet fetare, në mënyrë që po të gjente ndonjë të krishterë brenda apo rreth sinagogave, “burra o gra, të mund t’i sillte të lidhur në Jerusalem” (Veprat 9:2). Diku tjetër thotë se “e përndoqi këtë Udhë [kishën e krishterë] deri në vdekje” (Veprat 22:4). Ai “shkonte nga një sinagogë te tjetra duke i detyruar të blasfemonin” dhe “me zemërim të madh kundër tyre i përndoqi deri në qytete të huaja” (Veprat 26:11). Kur Stefani, martiri i parë i krishterë, u vra me gurë, “Sauli e kishte miratuar vrasjen e tij” (Veprat 8:1).

Me këtë dëshmi mbi tavolinë mund të shohim lehtësisht përse Pali duhej të ishte ndier i justifikuar kur e quante veten shërbëtor të zellshëm e të bindur të Perëndisë, duke bërë siç duhej çdo gjë që mundej për të çrrënjësuar një sekt blasfemues që besonte se po minonte ligjin e Perëndisë të vendosur në Dhiatën e Vjetër.

## Përfitim dhe humbje

Tani shikoni këtë! Pasi ka treguar këto shtatë arsye, katër të trashëguara dhe tri të fituara, se përse ai mund t'ia kalonte kujtqdo që pohonte se kishte “besim te mishi”, papritur Pali e përmbysi gjithë dëshminë e tij.

Por gjërat që më ishin fitim i konsiderova, për shkak të Krishtit, humbje... dhe i konsideroj si pleh, që unë të fitoj Krishtin dhe që të gjendem në të jo duke pasur drejtësinë time që është nga ligji, por atë që është nga besimi në Krishtin: drejtësia që është nga Perëndia, me anë të besimit” (Filipianëve 3:7-9).

Kur përdor fjalët “fitim” dhe “humbje”, Pali shkruan sikur të ishte biznesmen apo llogaritar, duke mbledhur hyrjet në regjistrin e jetës së tij. Fjala origjinale e përkthyer “fitim” në frazën hapëse është shumë dhe është një term mbulues që mbulon gjithë gjërat që i konsideronte të rëndësishme më parë. Megjithatë, sapo kishte besuar në Krishtin, kishte kuptuar që, në vend që të kishte ndonjë përfitim për të në lidhje me marrëdhënien e tij me Perëndinë, ato të gjitha mund të etiketoheshin “humbje”. Kjo nuk kishte qenë një fantazi utopike, një shpërthim emocional apo ndonjë kërcim i damarit fetar, por një bindje e theksuar dhe e fuqishme. Këtij mendimtari të shkëlqyer, i zhytur që nga lindja në ide fetare që e shikonin të qenit në rregull me Perëndinë si kombinim i prejardhjes me përpjekjen, iu revolucionizua të menduarit sapo hyri në një marrëdhënie të gjallë me Krishtin. Tani, si i krishterë i pjekur, kishte arritur të kuptonte se gjërat që dikur i llogariste si fitim ishin jo thjesht një “humbje” e plotë, por “plehra”. Fjala greke origjinale, “*skubalon*”, fjalë për fjalë do të thotë “diçka që u hidhet qenve”. Në vende të tjera në letërsinë e asaj kohe përdorej për fundërrina, refuzim, gjëra që janë të pavlera, ndotjen e mendjes, madje edhe për bajgat. Kjo është një gjuhë tronditëse! Pali hedh vështrimin mbrapa te privilegjet priftërore, ato të racës dhe të prejardhjes dhe te një jetë përkushtimi ndaj mbajtjes së jashtme të çdo pike e presjeje të ligjit të Moisiut dhe tani thotë që, për ta bërë atë të jetë në rregull me Perëndinë, këto gjëra nuk kanë më shumë meritë sesa plehu!

Kjo mund të tingëllojë e paarsyeshme dhe qesharake, por të braktisësh besimin te privilegji ose përpjekja njerëzore është një prej kërkesave biblike

më themelore që të jesh në rregull me Perëndinë. Një prej profetëve të Dhiatës së Vjetër e shpreh aq hapur sa edhe Pali kur shkruan: “Jemi të gjithë si një gjë e papastër, dhe të gjitha veprat tona të drejtësisë janë si një rrobe e ndotur” (Isaia 64:6). Fjalët “rrobe e ndotur” përdoren për përkthimin e një shprehjeje në hebraisht për rroba të njollosura nga gjaku i menstruacioneve të një gruaje, prandaj profeti thotë se, që të jemi në rregull me Perëndinë, edhe gjërat më të mira që bëjmë, “veprat tona të drejta”, jo vetëm janë të pafuqishme, por të ndotura.

Tri pasazhe të Dhiatës së Re e zhvillojnë këtë mendim me logjikë shkatërruese. I pari thotë: “Sepse kushdo që e zbaton gjithë ligjin, por e shkel në një pikë, është fajtor në të gjitha pikat . . . Prandaj, nëse ti nuk shkel kurorën, por vret, ti je shkelës i ligjit” (Jakobi 2:10-11). Më mirë të mos e humbasim mesazhin që jepet këtu! Nuk po thotë se personi që kryen një mëkat të veçantë duhet të jetë fajtor për kryerjen e çdo mëkati tjetër, dhe as nuk po thotë se të shkelësh një pjesë të ligjit të Perëndisë do të thotë se thyen çdo pjesë të tij. Ajo që thuhet është se ligji i Perëndisë është një njësi, se edhe një mëkat bën që ligji, si një i tërë, të shkelet. Nuk është si një test që kërkon t’u jepet përgjigje vetëm gjashtë nga dhjetë pyetjeve që të quhet i kaluar. Dhe as nuk është si një piring gurësh nga i cili mund të hiqet një, pa ndonjë ndryshim domethënës në madhësinë e piringut. Përkundrazi, është si një fletë xhami, një kërcitje dhe i gjithë xhami thyhet. Mund të përdorim një numër ilustrimesh të tjera për të arritur në të njëjtin përfundim: një shpim dhe gjithë goma bie; një hallkë e hequr dhe gjithë zinxhiri shpëputet; një vrimë në barkë dhe e gjitha fundoset. Askush nuk mund ta kundërshtojë Biblën kur ajo pyet: “Kush mund të thotë: ‘Pastrova zemrën time, jam i pastruar nga mëkati im’” (Fjalët e Urta 20:9).

Në pasazhin e dytë, Pali e konfirmon këtë në mënyrën më të theksuar të mundshme, duke mbështetur mësimin e Dhiatës së Vjetër: “Nuk ka asnjëri të drejtë, as edhe një . . . asnjë që të bëjë të mirën, as edhe një” (Romakëve 3:10,12). Teologët e quajnë këtë doktrinën e privimit total. Kjo nuk do të thotë se çdo mendim, fjalë dhe veprim i çdo personi është më i keq, por do të thotë se edhe mendimi ynë më i mirë, fjalët dhe veprimet tona deri diku janë të ndikuara nga mëkatshmëria jonë e trashëgueshme.

Në pasazhin e tretë, Pali shton pikën e qartë se personi që përpiket të justifikojë veten me anë të ushtrimit të fesë (në atë kohë në mendje kishte rrethprerjen) është i destinuar të dështojë, sepse “ai është i detyruar të zbatojë mbarë ligjin” (Galatasve 5:3, theksimi i shtuar nga autori). Më lart, në të njëjtën letër, ai përdori një pohim të Dhiatës së Vjetër dhe shkroi: “Të gjithë ata që themelohen mbi veprat e ligjit janë nën mallkim, sepse është shkruar: “I

mallkuar është kushdo që nuk qëndron në të gjitha ato që shkruhen në librin e ligjit për t'i praktikuar". Sepse me anë të ligjit askush nuk shfajësohet përpara Perëndisë (Galatasve 3:10-11). Kjo në asnjë mënyrë nuk po bënte që ligji të merrte të tatëpjetën, por po vinte në pah se ishte dhënë jo si ndonjë fletë testi (sepse nota e vetme kaluese e pranueshme nga Perëndia do të ishte 100%), por, së pari, për të treguar se ku po gabojmë, me fjalë të tjera të na bindë ne se jemi shkelës të ligjit, mëkatarë fajtorë në sytë e një Perëndie të shenjtë. Hapi i parë që secili prej nesh duhet të marrë, në mënyrë që të jetë në rregull me Perëndinë, është të kuptojë se po të ngelemi në dorën tonë ne jemi gabim me Perëndinë, prandaj na është dhënë ligji që të na tregojë se kështu qëndron puna.

## Spiralja e tatëpjetë

Deri tani tregimi ka shkuar nga keq në më keq, siç mund ta shohim nëse përmbledhim dhe nënvizojmë atë që kemi zbuluar.

- Asnjë person i arsyeshëm nuk mund të mohojë se, si qenie njerëzore, kemi një sens të brendshëm se ka një ndryshim të madh mes së drejtës dhe së gabuarës. Të përpiqesh ta mohosh këtë është si të luash me dinamitin.
- Ky sens moral merr shkas nga ndërgjegjja, një monitor moral që gjykon mendimet, fjalët dhe veprimeve tona.
- Ne nuk mund të gjejmë asnjë bazë morale të qëndrueshme dhe të besuar për ndërgjegje në natyrë, në veten tonë apo në kulturë.
- Vetëm Perëndia është shpjegimi për sensin tonë moral, sepse pa të nuk kemi ndonjë mënyrë të pagabueshme për të dalluar të drejtën nga e gabuara.
- Pyetja më e madhe është: "A mund të jemi mjaft të mirë për Perëndinë pa Perëndinë?", dhe përgjigjja është një "Jo" e theksuar. Bibla e bën të njohur këtë në mënyrën më të qartë të mundshme, duke thënë se "të gjithë kanë mëkatuar dhe kanë rënë nga lavdia e Perëndisë" (Romakëve 3:23). Jo vetëm që nuk kemi arritur të jetojmë sipas ligjit të Perëndisë (që është një reflektim i natyrës së tij), por *ne vazhdojmë të veprojmë kështu çdo ditë të jetës sonë*. Një pohim i vetëm në Shkrim mjafton për të treguar se nuk ka kuptim të përpiqesh ta shmangësh këtë verdikt. Kur dikush e pyeti Jezuin "Cili është i pari i gjithë urdhërimeve?", ai u përgjigj: "Urdhërimi i parë i të gjithëve është . . . duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde" (Marku 12:28-30). Kjo përmbledhje e mrekullueshme e katër urdhërimeve të para

nga Dhjetë Urdhërimet lë secilin prej nesh “fajtor”, prandaj, të mohosh këtë, e bën fajin tonë edhe më të rëndë. Deri tani nuk kam marrë pjesë në funeralin e ndonjë njeriu “të keq”! Herë pas here, edhe për dikë që nuk ka pasur lidhje të dukshme me gjëra shpirtërore, për të mos thënë me fenë e organizuar, kanë folur me fjalë të shndritshme: “Nuk i bëri kurrë keq njeriu”; “Ishte e mirë me të gjithë”; “Ai ishte i ndershëm dhe i drejtë në çdo gjë që bëri”; apo “Ajo ishte një shoqe dhe fqinjë e mirë”. T’i bësh furça të vdekurit mund t’i ngushëllojë ata që mbajnë zi, por vështirë se mund të japë një tablo tërësisht të ndershme.

- Asnjë avantazh që mund të kemi trashëguar përmes racës apo fesë nuk mund të bëjë ndonjë gjë për ta mundur apo edhe për ta reduktuar këtë deficit moral. Çfarëdo qoftë prejardhja jonë, origjina apo mënyra e rritjes, çfarëdo rituale apo ceremoni fetare që mund të kemi kryer (duke përfshirë edhe ato të praktikuara nga kisha e krishterë), të gjitha këto na lënë të ndarë nga Perëndia.
- Madje edhe gjërat më të mira që mendojmë, themi ose bëjmë janë po aq të pafuqishme. Asnjë sasi ndershmërie, pastërtie, përulësie, dashurie apo mirësie nuk mund të fshijë mëkatet tona.

Kësaj spiraleje të tatëpjetë të frikshme Bibla i shton një përdredhje të fundit. Ajo thotë se ata që vdesin në këtë gjendje do të gjykojnë nga Perëndia, i cili është “i përsosur në njohuri” (Jobi 37:16), sytë e të cilit janë “tepër të pastër për të parë të keqen” (Habakuku 1:13) dhe që tashmë ka vendosur që “nuk do të hyjë asgjë e papastër [në qiell] (Zbulesa 21:27). Ata, jeta e paperëndishme e të cilëve ka reflektuar rebelimin e tyre kundër rregullit të Perëndisë, “do të ndëshkohen me shkatërrim të përjetshëm, larg nga fytyra e Zotit dhe nga lavdia e fuqisë së tij” (2 Thesalonikasve 1:9). Për ta thënë më shkoqur, ata do të “hidhen në ferr” (Mateu 5:29).

## Përgjigjja vendimtare

Ligji i Perëndisë, i kristalizuar në Dhjetë Urdhërimet, u dha për të na treguar se, po të ngelemi në duart tona, të gjithë jemi të ekspozuar ndaj këtij fati të tmerrshëm, por Bibla na tregon se ligji ka një qëllim tjetër. E pasqyron njerëzimin jo vetëm si shkelës të ligjit, por si të burgosur, me ligjin e Perëndisë si oficerin e burgut, duke mbajtur në mbikëqyrje fajtorin, në mënyrë që ata të jenë gjithmonë të ndërgjegjshëm për fajin e tyre dhe për përgjegjësinë e tyre në

dënim, e megjithatë, në të njëjtën kohë, duke u treguar atyre të vetmen rrugë me të cilën mund të trajtohet mëkati i tyre dhe që burgosja e tyre të marrë fund. Sipas fjalëve të Biblës: “Ne ruheshim nën ligjin si të mbyllur, duke pritur besimin që duhej të zbulohej. Kështu ligji *qe mësuesi ynë për te Krishti*, që ne të shfaqësohemi me anë të besimit” (Galatasve 3:23-24).

Fjalët që kam theksuar janë në qendër të mesazhit të Biblës. Dhiata e Vjetër përfshin copa të mëdha historie, poezie dhe profecie, megjithatë të tridhjetë e nëntë librat bashkohen kur të drejtojnë jo te një parim por te një person, Mesia, të cilin Perëndia e premtoi për të çliruar popullin e tij. Rreth 400 vjet pasi ishte shkruar libri i fundit i Dhiatës së Vjetër, lindi Jezui nga Nazareti dhe, sapo ra në sy të njerëzve, ai filloi të tregonte se *ishte* Mesia. Fjala e njëjtë greke për “Mesia” është “Krishti”, fjalë që përdoret për Jezuin mbi 500 herë në Dhiatën e Re, ose si titull apo pjesë e një emri personal, ndërkohë që vendlindja, mënyra e jetesës, karakteri, fuqia, ndikimi, vuajtja, vdekja dhe ringjallja e tij mbështesin pohimin e Biblës se, përtej çdo dyshimi, ai jo vetëm ishte Mesia i vërtetë, por “Biri i Perëndisë së gjallë” (Mateu 16:16), i cili “erdhi në botë të shpëtojë mëkatarët” (1 Timoteut 1:15). Është llogaritur se Jezui përmbushi rreth 300 profeci mesianike, gjë që merr kuptim vetëm nëse pranojmë pohimin e tij të qartë se “Shkrimet . . . dëshmojnë për mua” (Gjoni 5:39).

Për të kuptuar se si i shpëton ai mëkatarët, na duhet të përqendrohemi jo në lindjen apo jetën e tij, por në vdekjen e tij, e cila zë rreth një të tretën e Ungjijve që flasin më shumë për biografinë e Jezuit. Gjëja më domethënëse që ai bëri ishte të vdiste, e cila shpjegon përse simboli universal i besimit të krishterë nuk është një gjë që të kujton karakterin e tij të pamëkëkat, mësimdhënien e tij të pashoqe apo mrekullitë shtangëse, por një kryq, vegla më mizore e torturës dhe ekzekutimit që njihej në botën e lashtë.

Lidhja ndërmjet mëkatit dhe vdekjes është kaq e fortë, saqë Bibla e quan atë “ligji i mëkatit dhe vdekjes” (Romakëve 8:2). Ky ligj është po aq i pandryshueshëm dhe themelor sa është ligji i rëndesës. Vdekja, fizike dhe frymërore, është ndëshkimi i drejtë i Perëndisë për mëkatin. Para se mëkati të hynte në botë, vdekja nuk ishte e mundur; qysh atëherë u bë e paevitueshme. Por kjo duket se paraqet një problem të rëndë. Si një qenie e vërtetë njerëzore, Jezui “u tundua në të gjitha ashtu si ne, por pa mëkatuar” (Hebrenjve 4:15). Atëherë, përse vdiq ai? Përgjigjja e Biblës për këtë pyetje është e mrekullueshme dhe e rëndësishme: “Krishti ka vuajtur një herë për mëkatet, i drejti për të padrejtët, për të na çuar te Perëndia” (1 Pjetrit 3:18). Diku tjetër thotë se “Perëndia e tregon dashurinë e tij për ne në atë që, ndërsa ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne” (Romakëve 5:8).

Këtu kemi përgjigjen e mahnitshme ndaj pyetjes: “Si mund të fshijë mëkatet e kujtdo një Perëndi i drejtë dhe ta shpallë atë njeri të pranueshëm në sytë e tij pa shtrembëruar rregullat dhe pa vënë në rrezik drejtësinë e tij?” Po ta shohësh atë nga një kënd tjetër, si mund ta ndëshkojë Perëndia mëkatin (ashtu si duhet), e përsëri ta shpallë një fajtor të lirë nga faji dhe pasojat e tij? Zgjidhja e habitshme që Perëndia u bën këtyre dilemave të pamundura u siguria në jetën dhe vdekjen e birit të tij, Jezu Krishtit. Ligji i Perëndisë kërkon që ai të mbahet me përsosmëri dhe se që të gjithë që nuk arrijnë ta bëjnë këtë duhet ta paguajnë dënimin e tij plotësisht, dhe Jezui i bëri të dyja! Jeta e tij ishte “e shenjtë, e pafaj, e papërlyer, e ndarë nga mëkatarët” (Hebrenjve 7:26), megjithatë në vdekjen e tij pagoi plotësisht dënimin fizik dhe shpirtëror të mëkatis. Këto nuk ishin disa marrëveshje mes Perëndisë Atë dhe Perëndisë Bir. Përkundrazi, Jezui, Perëndia në formë njerëzore, e pagoi borxhin e mëkatis plotësisht; ashtu si dikush me të drejtë ka thënë: “Ai shkoi deri në kryq për të mbaruar punë plotësisht me mëkatin”.

Realiteti i asaj që Jezui arriti në vdekjen e tij u verifikua tri ditë më vonë, kur ai “u deklarua Biri i Perëndisë në fuqi . . . nëpërmjet ringjalljes prej së vdekurit” (Romakëve 1:4), një ngjarje e mbështetur në një masë dëshmie kaq të patundur, sa që 2000 vjet më vonë askush nuk ka qenë në gjendje t’i luajë as edhe një fije floku pohimit të Biblës se “Jezui vdiq dhe u ringjall përsëri” (1 Thesalonikasve 4:14). Mbi 500 njerëz e panë atë gjatë gjashtë javëve që pasuan, para se të ngjitej në qiell, dhe që atëherë me miliona kanë dëshmuar për fuqinë e tij të gjallë në jetët e tyre.

## Pika e kthimit

Mbetet një pyetje shumë e rëndësishme: si mund të përfitojë ndonjë nga ajo që Jezui arriti në jetën dhe vdekjen e tij? Si mund të bëjë jeta dhe vdekja e Jezuit që kujtdo t’i falen mëkatet dhe të hyjë në një marrëdhënie të gjallë dhe të përjetshme me Perëndinë? Çështja është kaq urgjente dhe personale, sa do të doja të kaloja në të shkruarit në vetën e dytë njëjës, të të shkruaja ty dhe jo ndonjë lexuesi anonim, dhe po ashtu dua ta mbështes pjesën që mbetet të kësaj broshure në një pohim të Dhiatës së Vjetër që ka të bëjë shumë në këtë pikë: “Ata që jepen pas kotësive të rreme braktisin vetë burimin e hirit të tyre” (Jona 2:9).

Gjëja e parë që duhet vënë re është se ka njerëz që lenë pas dore “burimin e hirit të tyre” (do ta shqyrtojmë këtë shkurtimisht) për një arsye të thjeshtë: “ata varen tek idhuj të pavlerë”. Fjalori i Gjuhës Shqipe e përkthyer në një idhull

si “statujë a figurë që adhurohet si hyjni”. Një gjë thelbësore rreth një idhulli është se është i bërë nga njeriu. Është e qartë që idhujt përfshijnë hyjnitë e shpikura nga qytetërime si perandoritë e lashta greke dhe romake, po ashtu edhe miliona perëndi që gjenden në fe të lashta që nga Lindja e kudo. Por idhujt mund të jenë gjithashtu ide, nocione që njerëzit kanë dhe ndaj të cilave ata përkushtojnë jetën e tyre. Ideja se e fitojmë shpëtimin tonë me përpjekjet tona në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë, apo të paktën kontribuojmë për të, është pa dyshim një prej tyre.

Tashmë kemi parë se kjo ide është pa bazë dhe e falimentuar, por më lejo ta shpie deri në fund. Nëse për pyetjen në lidhje me të qenit në rregull me Perëndinë i beson origjinës tënde dhe pohon gjërat të tilla si “kam lindur në një vend të krishterë” (nuk ka vend të tillë meqë ra fjala) ose “jam rritur në një familje të krishterë”, po mbahesh pas një idhulli të pavlerë. Nëse sheh faktin që u bëtë i krishterë, u përkushtuat, u pranuat, u pagëzuat apo u bëtë anëtar i kishës, po mbahesh pas një idhulli të pavlerë. Nëse beson në faktin që shkon herë pas here në kishë (ose edhe rregullisht) apo që mbështet çështjet e kishës duke dhënë para dhe duke kushtuar kohë, po mbahesh pas një idhulli të pavlerë. Nëse i jepni shumë rëndësi faktit që keni një detyrë në kishë apo në ndonjë organizatë tjetër fetare, apo keni të dhëna për një shërbesë besnike në punë bamirësie që synon të ndihmojë njerëzit në nevojë, po mbahesh pas një idhulli të pavlerë. Nëse mbështetesh në pohimin se për shkak se jeta jote është moralisht dhe frymërisht më e mirë se ajo e shumë njerëzve të tjerë, Perëndia do ta llogarisë ndershmërinë, integritetin, mirësinë dhe moralshmërinë tënde kur të vendosë fatin tënd, po mbahesh pas një idhulli të pavlerë.

Miliona njerëz bëjnë të njëjtin gabim tragjik duke supozuar se, për shkak se “Perëndia është dashuri” (1 Gjonit 4:8), ai do t’i fusë gjithë dështimet e tyre poshtë tapetit dhe t’i marrë ata në qiell. Por nuk ka as edhe një fije dëshmie biblike për ta mbështetur këtë, ndërkohë që herë pas here ka paralajmërimin më të qartë se kjo gjë nuk do të ndodhë. Nëse të gjithë do të shkojnë në qiell, pavarësisht nga besimi apo sjellja e tyre, përse Jezui paralajmëroi se mëkatarët e papenduar do të “shkojnë në mundim të përjetshëm” (Mateu 25:46). Po ta kishte gabim, ose duhej të ishte injorant (që nuk e dinte se të gjithë do të shkonin në qiell), ose joetik (duke i frikësuar njerëzit me kërcënime tmerruese, për të cilat e dinte se ishin të pabaza). Universalizmi, ideja se Perëndia garanton qiellin për të gjithë, nuk është gjë tjetër veç një idhull i pavlerë.

Të përpiqesh të jesh në rregull me Perëndinë me anë të këtyre mënyrave, është si të përpiqesh të shërosh një plagë të qelbëzuar duke e mbuluar atë me një rrobë me mikrobe. Hapi i parë që duhet të bësh është të mos besosh asnjë prej

tyre. Duhet të braktisësh çfarëdo besimi që po vendos në ndonjë prej tyre dhe të kuptosh se ato janë plotësisht të pavlera për sa i përket të qenit në rregull me Perëndinë; ashtu si apostulli Pal duhet “t’i konsideroni plehra”. Fjala e Biblës për ta bërë këtë është *pendim* dhe Jezui e bëri të qartë se, “nëse ju nuk pendoheni . . . do të vdisni” (Luka 13:3). Të pendohesh do të thotë të kthehesh nga mëkati, duke përfshirë mëkatin e të besuarit në çdo gjë tjetër veç Jezu Krishtit. Përfshin ndryshim të mendjes, ndryshim të zemrës dhe ndryshim të vullnetit. Asgjë më pak nuk do të funksionojë:

I pabesi le ta lërë rrugën e tij  
dhe njeriu i padrejtë mendimet e tij,  
dhe le të kthehet tek Zoti që të ketë dhembshuri për të,  
te Perëndia ynë që fal bujarisht”.

(Isaia 55:7)

Vëreni rendin e këtyre fjalëve! Duhet ta braktisni mëkatin para se Perëndia ta falë atë. Duhet të ketë *pendim nga* mëkati, jo thjesht keqardhje *për* të. Pendimi nuk është i vërtetë nëse nuk ka vullnet të vërtetë për ta lënë mëkatin dhe për të jetuar në një mënyrë që e kënaq Perëndinë.

Nëse hapi i parë për t’u bërë i krishterë i vërtetë është pendimi, i dyti është *besimi*. Fjalët “besim” dhe “të besuar” janë mes fjalëve që përdoren më shpesh kur bëhesh i krishterë, e megjithatë janë gjithashtu mes atyre fjalëve që keqkuptohen dhe keqpërdoren zakonisht. Kur Bibla të urdhëron të “besosh” në Jezu Krishtin apo të kesh “besim” në të, do të thotë më shumë se të besosh se ai ekzistoi apo madje të besosh se ai është Biri i përjetshëm i Perëndisë, i cili erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët. Kjo bëhet e qartë nga fakti që një frymë e keqe njëherë shpalli se Jezui është “i Shenjti i Perëndisë” (Marku 1:24), një konfirmim befasues i pohimit të Biblës se “edhe demonët besojnë... dhe dridhen” (Jakobi 2:19).

Ashtu si me pendimin, besimi për të cilin ke nevojë duhet të përfshijë mendjen, zemrën dhe vullnetin tënd. Duhet të përfshijë *mendjen* tënde në atë që duhet të pranoni se Jezui është pikërisht ai që pohoi se ishte. Ashtu si pohon ai vetë: “Po të mos besoni se unë jam, ju do të vdisni në mëkatet tuaja” (Gjoni 8:24). A beson me mendjen tënde? A beson me të vërtetë se pohimi i tij ishte i vërtetë, se ai është “Perëndia i vërtetë” (1 Gjoni 5:20) dhe se ai erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarë si ty?

Duhet të përfshijë *zemrën* tënde. Zemra është qendra e emocioneve, dëshirave dhe ndjenjave të tua, prandaj Bibla thotë: “Sepse me zemër njeriu

beson në drejtësi dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim” (Romakëve 10:10). A beson me zemrën tënde? A të ka mbërthyer e vërteta që mendja jote ka kuptuar? A e ndien se Jezui vdiq për ty? A ke një dëshirë të zjarhtë që të largohesh nga mëkatet që shkaktuan vdekjen e tij dhe ta besosh atë si Shpëtimtarin tënd personal?

Duhet të përfshijë gjithashtu *vullnetin* tënd. Besimi që bashkon një person me Jezu Krishtin është një veprim përkushtimi personal, jo thjesht një kombinim njohurie dhe ndjenjash. Ky aspekt i besimit nuk ka të bëjë shumë me të besuarit në Jezuin sa të besuarit *mbi* të. Do të thotë të hidhesh mbi të plotësisht aq sa një person që po mbytet do t'i besonte një barke shpëtimi, aq sa një pacient do t'i besonte kirurgut, apo një pasagjer pilotit të avionit. Do të thotë përkushtim me gjithë zemër, pa asnjë rezervim, pa hezitim, pa kompromis dhe pa kushte. A beson me vullnetin tënd? Predikuesi skocez i shek. XVI-të David Dickson e përshkruante në këtë mënyrë afrimin e tij në pendim dhe besim: “Mora veprimet e mia të këqija dhe i *hodha në një grumbull* mbeturinash; dhe pastaj mora veprat e mia të mira, i *hodha në të njëjtin grumbull* dhe i besova Krishtit plotësisht”. Vini re fjalët që kam theksuar! Për shumë njerëz, çështja kryesore nuk është ajo e të kthyerit nga mëkati i dukshëm, por ai i të kthyerit nga mëkati “i fshehur” i të besuarit në atë që ata pohojnë se janë “veprat e tyre të mira”. Mos guxo të bësh të njëjtin gabim!

## Hiri: i gjetur apo i braktisur?

Pohimi nga Dhiata e Vjetër që po shqyrtojmë regjistron tragjedinë e atyre që “braktisin vetë burimin e hirit të tyre, prandaj dua ta mbyll duke u përqendruar mbi këtë frazë. “Hir” do të thotë nder i pamerituar dhe falas i Perëndisë ndaj mëkatarëve, diçka e sinkronizuar mirë nga apostulli Pal kur u kujton të krishterëve të hershëm: “Sepse ju e njihni hirin e Zotit tonë Jezu Krisht, i cili, duke qenë i pasur, u bë i varfër për ju, që ju të bëheni të pasur me anë të varfërisë së tij” (2 Korintasve 8:9). Këtu është thelbi i ungjillit të krishterë! Jezui la lavdinë e qiellit, iu nënshtrua gjithë kufizimeve të jetës në tokë, lejoi që të poshtërohej, të abuzohej dhe të hidhej poshtë, duroi tundim të çdo lloji dhe, së fundi, lejoi që të vritej nëpërmjet kryqëzimit, metoda më e egër e ekzekutimit që njëherë atëherë nga njerëzit, dhe e bëri të gjithë këtë që mëkatarë të cilët nuk e meritonin, si ti dhe unë”, të mund të bëheshin të pasur”, dhe sa i pasur mund të bëhesh . . . !

*Falja e mëkateve* mund të jetë e jotja. Bibla nuk mund të ishte më e qartë për këtë: “Kushdo që beson në të, merr faljen e mëkateve me anë të emrit të tij” (Veprat 10:43). Mund të jesh i lirë nga çdo frikë dënimi Ditën e Gjykimit, duke e ditur se Jezui ka paguar plotësisht dënimin që ti meritoje.

*Paqja me Perëndinë* mund të jetë e jotja. Pali i siguronte bashkëbesimtarët e tij se, si të krishterë, “kemi paqe me Perëndinë përmes Zotit tonë Jezu Krisht” (Romakëve 5:1). Nga natyra ti ke një armiqësi të brendshme kundrejt Perëndisë, prandaj je nën zemërimin e drejtë të Perëndisë, por, po të vendosësh besimin te Krishti, lufta do të mbarojë dhe do të kesh një paqe të brendshme që “ia kalon çdo njohurie” (Filipianëve 4:7) dhe që do të mbetet edhe kur të përballesh me stuhitë e jetës.

*Jeta e përjetshme* mund të jetë e jotja. Ndërsa mëkati sjell vdekje fizike dhe frymërore, “dhuntia e Perëndisë është jeta e përjetshme në Jezu Krishtin, Zotin tonë” (Romakëve 6:23). Kjo do të thotë pafundësisht më tepër se të jetosh përjetë; do të thotë ta bësh këtë në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë, duke iu gëzuar pranisë së tij të lavdishme, duke e adhuruar atë me gëzim ballë për ballë, duke u gëzuar në bukurinë e tij dhe duke u kënaqur në bekimet frymore që ai do të derdhë mbi ty përjetë.

*Prania e përditshme e Perëndisë* mund të jetë e jotja. Ndërsa jeta e përjetshme është e përsosur në qiell, për besimtarin e krishterë ajo fillon këtu në tokë, në çastin kur ai ose ajo bëhet i krishterë. Do të kesh të njëjtën përvojë me miliona besimtarë të tjerë që zbulojnë se “të shumta janë dhembjet e të pabesit, por ai që ka besim te Zoti do të rrethohet nga mirësia e tij” (Psalmi 32:10).

*Fuqia frymërore mund të jetë e jotja.* Pavarësisht nga vetëbesimi ynë, ka kohë kur zbulojmë se nuk jemi në gjendje të merremi me trauma të papritura apo presion të vazhdueshëm. Si i krishterë do të zbulosh se nuk do të të duhet të përballesh vetëm me këto gjëra, se “Zoti do t’i japë forcë popullit të tij; Zoti do të bekojë popullin e tij me paqe” (Psalmi 29:11) dhe se, për shkak se ke një marrëdhënie të gjallë me Jezu Krishtin, do të jesh në gjendje të marrësh nga urtësia, hiri dhe fuqia e tij ditë pas dite.

Gjithë këto bekime mund të jenë të tuat! Përse t’i humbasësh ato duke besuar në “idhuj të pavlerë” që do të të nxjerrin jashtë përgjithmonë nga mbretëria e Perëndisë? Përse të kënaqesh me skenarin e pashpresë të Polly Toynbee, në

të cilin “askush nuk shikon, askush nuk drejton, askush nuk gjykon dhe nuk ka asnjë vend tjetër në të ardhmen . . . askush nuk është këtu, veç nesh, për të vuajtur për mëkatet tona, askush për të na shpenguar veç nesh . . .”?

Të nxis që t’i largohesh këtij botëkuptimi shterp tani, të hedhësh tutje gjithë “idhujt e pavlerë”, t’i besosh Jezu Krishtit si Shpëtimtarit tënd dhe ta marrësh atë si Zotin tënd, ndërsa Perëndia në durimin dhe mëshirën e tij po të thërret ta bësh këtë sa është ende “dita e shpëtimit” (2 Korintasve 6:2).

## Shënime

1. "Daily Mail", 9 dhjetor 2005.
2. "New York Daily News", 8 dhjetor 2005.
3. "San Francisco Chronicle", 9 dhjetor 2005.
4. "Baltimore Sun", 9 dhjetor 2005.
5. "Guardian", 5 dhjetor 2005.
6. "Oxford Dictionary of English", Oxford University Press, 2001, fq. 595.
7. Si më sipër, fq. 1140.
8. Josh McDowell & Don Stewart, "A Concise Guide to Today's Religions", Scripture press, fq. 375.
9. Jacob Bronowski, "The Identity of Man", Penguin, fq. 8.
10. C. S. Lewis, "There Christianity", Macmillan, fq. 21.
11. Phillip E. Johnson, "Objections Sustained", Inter-Varsity Press, fq. 180.
12. Everyman, "BBC Television", 8 shtator 1996.
13. Cituar nga Phillip E. Johnson, "Darwin on Trial", Monarch Publications, fq. 114.
14. "Daily Telegraph", 5 tetor 1996.
15. Rodney E. Holder, "Nothing but Atoms and Molecules?", Monarch Publications, fq. 125.
16. "Daily Telegraph", 31 gusht 1992.
17. Richard Dawkins, "The Selfish Gene", Granada Publishing, fq. 2.
18. C. S. Lewis, "Miracles", Collins, fq. 122.
19. "Sunday Times", 4 janar 1998.
20. Crawford Gribben, "Evangelical Times", janar 2000.
21. Cituar nga Gribben, si më sipër.
22. Allan Bloom, "The Closing of the American Mind", Simon & Schuster, f. 25.
23. Roger Scruton, "Modern Philosophy", Sinclair & Stevenson, fq. 6.
24. "Daily Telegraph", 17 janar 1995.
25. Cituar nga J. Andrew Kirk, "Loosing the Chains", Hodder & Stoughton, fq. 53.
26. David Broughton Knox, "Not by Bread Alone", Banner of Truth Trust, fq. 2.
27. "Daily Telegraph", 7 korrik 1994 (theksimi i shtuar nga autori).
28. C. S. Lewis, "Mere Christianity", Collins, fq. 45-6.
29. Cituar nga "Draper's Book of Quotations for the Christian World", Tyndale House, fq. 238.
30. "God – For or Against?", debat televiziv në Universitetin e Oksfordit më 1998.
31. Peter C. Moore, "Disarming the Secular Gods", Inter-Varsity Press, fq. 158.
32. Letër personale për autorin, 3 nëntor 1998.